

**Fehd bin Jahja El-Amari**

# **LUTJET E AGIMIT**

**Përktheu nga origjinali:  
Kastriot Bardhi**

**Korça Kultura Feja**

***Titulli origjinal i librit :***

زاد جلسة الإشراق

(Zadu xhelseti el-ishraki)

***Autori: Fehd bin Jahja El-Amari***

***Gjykatës në Gjykatën e Apelit në Mekën e Shenjtë***

***email: Famary1@gmail.com***

**2018**

## PARATHËNIE

### Me emrin e Allahut Mëshiruesit, Mëshirëplotit!

Falenderimet e plota i takojnë vetëm Allahut.

Paqja, bekimet dhe mëshira e Allahut qofshin për Muhamedin ﷺ, pas të cilit nuk ka më Profet tjetër.

Ymeti<sup>1</sup> islam, në kohën tonë, po kalon një periudhë të vështirë. Po luftohet në çdo aspekt, me qëllim asgjësimin dhe asimilimin. E gjithë kjo bëhet nën petkun e mëshirës, që në thelb është dashakeqësi dhe ndëshkim. Ky ymet vuan padrejtësinë, brutalitetin dhe agresionin në forma dhe lloje të ndryshme.

Ymeti ynë po përjeton një ndër periudhat më të vështira të historisë së tij. Armiku e ka vënë poshtë, ia ka shkelur nderin dhe ka bërë të provojë forma nga më të ndryshmet të shtypjes e të padrejtësisë, të dhunës e të persekutimit, të justifikuara me argumente dhe interpretime djallëzore, me të cilat janë mashtruar shumë njerëz.

Një grup, që pretendon Islamin, i vënë në shërbim të armikut brutal e mizor, është një tjetër fatkeqësi e madhe, e cila, në fakt, e ka zanafillën qysh në agimin e Islamit dhe e ka shoqëruar atë vazhdimisht përgjatë historisë së tij. Ata janë njerëz të infiltruar që kanë depërtuar në radhët e muslimanëve. Mbajnë emra të ndryshëm, por kanë cilësi të njëjta dhe ndërrmarin veprime të përbashkëta e të koordinuara kundër Islamit dhe muslimanëve.

Vështirësitë dhe sprovat janë të natyrshme për individët dhe

1) Fjala “Ymet” përdoret edhe në shqip dhe ka kuptimin: bashkësi, komunitet. (shën. përkth.)

## **Fehd bin Jahja El-Amari**

---

shoqëritë. Individit sprovohet, gjithashtu edhe shoqëria. Jeta nuk ecën në të njëjtin ritëm.

Sigurisht, çdo gjë ndodh me vullnetin e Zotit dhe sipas urtësisë së Tij. Ne besojmë në caktimin e Allahut. Konflikti ndërmjet të vërtetës dhe të kotës është një ligj i hershëm që në vigjilie të shoqërisë. Ky konflikt herë ashpërsohet dhe herë dobësohet. Me anë të tij Zoti i Lartësuar rregullon ekuilibrat; bën që të dallohet i keqi nga i miri; vë në provë besimin e njeriut; zbulon atë çfarë ai fsheh në zemër; ngre disa njerëz dhe poshtëron disa të tjerë.

“الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا وَهُوَ الْعَزِيزُ الرَّحِيمُ”

**“Ai i Cili ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush vepron më mirë; Ai është i Plotëfuqishmi dhe Falësi i madh.”** (El-Mulk: 2)

“لِيَمِيزَ اللَّهُ الْخَبِيثَ مِنَ الطَّيِّبِ”

**“Që Allahu të veçojë të keqin nga i miri.”** (El-Enfal:37)

“وَلِيَمْحَسَ اللَّهُ الَّذِينَ آمَنُوا وَيَمْحَقَ الْكَافِرِينَ”

**“Që Allahu t’i pastrojë besimtarët dhe t’i shkatërrojë jobesimtarët.”** (Al Imran:141)

Muslimani jeton mes këtyre sprovave dhe mund të zhytet në to. E keqja është përhapur kudo dhe ajo mund të depërtojë në zemër e në shpirt; mund ta vështirësojë dëgjimin dhe ta errësojë shikimin e së vërtetës. E gjithë kjo, për të vënë në provë besimin dhe për të dalluar të mirin nga i ligu.

Sa njerëz janë zhytur në ligësi dhe e kanë shitur fenë dhe parimet e tyre?! Sa të tjerë janë prekur prej saj?! Një pjesë

e njerëzve janë të luhatur dhe të paqëndrueshëm në besim. Ndërkaq, një pakicë prej tyre që janë të qëndrueshëm si malet, sepse Allahu i ka bërë të tillë.

## **Faktorët e qëndrueshmërisë**

Dituria dhe adhurimi janë dy faktorët më të rëndësishëm që e bëjnë njeriun të qëndrueshëm përballë provave. Këto duhet të jenë bashkë. Përqëndrimi te njëra duke e nënvlerësuar tjetrën është shkak për rrëshqitje dhe mungesë ekuilibri. Fatkeqësisht, e tillë është gjendja e shumë njerëzve. I udhëzuar në rrugën e drejtë është ai që e harmonizon diturinë me adhurimin dhe gjen strehë tek të dyja. Me këto të dyja arrihet udhëzimi dhe drejtësia. Qëllimi i diturisë është që ajo të zbatohet në praktikë. Vepra është frut i diturisë dhe synimi i saj.

O ju njerëz!

Studiuesi i teksteve të shenjta, të Kuranit dhe Traditës Profetike, gjen në to nxitje e inkurajim për kërkimin e diturisë dhe urdhëresa për t’iu përkushtuar adhurimit.

Allahu i Lartësuar thotë:

“يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اسْتَعِينُوا بِالصَّبْرِ وَالصَّلَاةِ إِنَّ اللَّهَ مَعَ الصَّابِرِينَ”

**“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me durimtarët.”** (El-Bekare: 153)

Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë:

“وَلَقَدْ أَخَذْنَاَهُمْ بِالْعَذَابِ فَمَا اسْتَكَانُوا لِرَبِّهِمْ وَمَا يَتَضَرَّعُونَ”

**“Ne i dënuam ata njëherë, por ata nuk i përlulën Zotit të tyre e as nuk i drejtuan lutje.”** (El-Muminun:76)

Adhurimi zë vend të rëndësishëm në hadithet e Profetit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të). Përkushtimi ndaj adhurimit, me fjalë dhe me vepra, shpërblehet shumë te Allahu i Lartësuar:

1. Në këtë kontekst, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) thotë: *“Adhurimi në kohë sprovash është sikurse emigrimi tek unë.”*<sup>2</sup>

Hafiz Ibën Rexhepi thotë: *“Arsyeja është se: njerëzit në kohë sprovash ndjekin tekat e tyre dhe e braktisin fenë. Në këtë kohë, gjendja e tyre ngjan me atë të periudhës së Injorancës. Ai që veçohet nga të tjerët, mbahet fort në fenë e tij dhe e adhuron Zotin për të fituar kënaqësinë e Tij, duke u larguar nga çdo gjë që e zemëron Atë, ky njeri është në pozitën e atij që shpërngulet nga injorantët dhe shkon te i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të); i beson, i zbaton urdhrat e tij dhe largohet nga çdo gjë që e ndalon ai (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).”*

El-Irakiu thotë: *“Kjo është arsyeja pse adhurimi në kohë sprovash merr vlera të mëdha.”*

2. Transmetohet nga Umu Seleme se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) një natë u çua i trembur dhe tha: *“La Ilahe ila Allah - Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut; sa prova kanë zbritur këtë natë dhe sa thesare janë zbuluar?! Kush i zgjon gratë që flenë në këto dhoma (ka për qëllim gratë e tij) që të falen? Sa gra të veshura (me begati) në këtë botë, do të jenë të zhveshura (nga begatitë) në botën tjetër!”*<sup>3</sup>

---

2) Muslimi 130.

3) Buhariu 5844.

Ibën Betali ka thënë:

*“D.m.th. kush po i zgjon ato që të falen natën?! Kjo tregon se namazi e shpëton njeriun nga të këqijat e sprovave dhe e mbron nga fatkeqësitë.”*

Gjithashtu Ibën Betali ka thënë: *“I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të na ka njoftuar se duhet të friksohemi kur të zbresin belatë; t’i drejtohemi Allahut me lutje dhe të falim namaz që ato të largohen, sepse Allahu i Lartësuar thotë:*

**”قُلُوبًا إِذْ جَاءَهُمْ بِأَسْنَانًا تَضَرَّعُوا”**

**“Vetëm sikur të përuleshin kur u erdhi ndëshkimi Ynë!”**  
(El-Enam: 43)

3. Medito për gjendjen e Profetit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) para betejës së Bedrit, kur ai lutej me lotë në sy. Ai qante duke u falur tërë natën derisa u gdhi.<sup>4</sup>

### **Frytet e adhurimit**

Adhurimi e ndriçon errësirën; ia largon etjen të eturit; në të gjen prehje dhe qetësi i brengosuri; është udhërrëfyes në udhëtim, siguri në këtë botë dhe në botën tjetër.

Adhurimi e rregullon njeriun, ia pastron zemrën e shpirtin, ia ruan mendjen dhe trupin.

Nëpërmjet adhurimit mbrohen shqisat dhe gjymtyrët nga gjynahet dhe fajet.

Me anë të adhurimit sigurohet fitorja, sukcesi, drejtësia dhe udhëzimi.

Nëpërmjet adhurimit fitohet kënaqësia e të Gjithëmëshirshmit

---

4) Transmeton Ahmed i 1023. Hadithin e ka saktësuar Ahmed Shakiri dhe Shuajb Arnauti.

## **Fehd bin Jahja El-Amari**

dhe dëbohet shejtani.

Adhurimi e shpëton njeriun nga sprovat, e pajis me durim dhe qëndrueshmëri për përballimin e fatkeqësive. Nëpërmjet adhurimit zemrat udhëtojnë drejt Njohësit të të fshehtave dhe shpirtrat mbushen me çfarë kënaqet Sunduesi, i Shenjti.

Me anë të adhurimit njeriu ndihmohet në çështjet e kësaj bote dhe të botës së përtejme.

Adhurimi e pastron shpirtin dhe e lartëson moralin. Me të njeriu i rregullon të metat, e lufton egon dhe shpëton nga zilia, lakmia, smira dhe urrejtja.

Me anë të adhurimit shpirtrat ngrihen në lartësitë e mirësisë e të virtytit, ngrihen në piedestalin e lavdisë dhe qëndrueshmërisë.

Adhurimi është prehje e qetësi; është mundësi e fitimit të shpërblimeve të mëdha.

Adhurimi i zbut dhe i gjallëron zemrat; ato ndikohen shumë shpejt prej tij. Me anë të adhurimit forcohet besimi, zhvillohen virtytet e larta morale dhe përjetohen ndjenja kënaqësie e lumturie.

Adhurimi është gara e shpirtrave lotues.

Nëpërmjet tij fitojmë mirësitë dhe mbrohemi nga fatkeqësitë.

Adhurimi i ndriçon fytyrat, i forcon zemrat dhe e frymëzon njeriun drejt së vërtetës.

Me anë të adhurimit njeriu e ndjen mbikëqyrjen e Allahut dhe e përjeton përrulësinë ndaj Tij; adhuruesi i frikësohet Allahut dhe përgatitet për udhëtimin drejt përjetësisë.

Me adhurimin arrihet fitorja dhe garantohet fuqizimi.

Adhurimi zhvillon tek njeriu rrënjët e pemës së mirësisë, nga frutet e së cilës përfitojnë të gjithë.

### **Adhurimi i humbur**

Adhurimi që bën zemra është më i rëndësishmi. Ky është adhurim i humbur në kohën tonë. Ai është bërë i huaj për zemrat, i panjohur tek njerëzit.

Në fakt, ky adhurim është lënda e vërtetë që i mban shpirtrat gjallë.

Shumë probleme, në marrëdhëniet tona me Zotin, me veten dhe me të tjerët, e kanë burimin te mungesa dhe dobësia e adhurimit të zemrës dhe veprave të saj.

Ky adhurim është anija e shpëtimit dhe e përqëndrimit, është pishtar për zemrën.

Adhurimi i zemrës është baza e ndjesisë; prej zemrës motivohen edhe shqisat e gjymtyrët në bindjen e nënshtrimin ndaj Zotit; prej saj marrin kuptimin e vërtetë të gjitha adhurimet.

E mendojmë veten në veprat që bëjmë me shqisa e gjymtyrë, por nuk e mendojmë atë në punët e zemrës. Për pasojë, struktura dobësohet dhe ndoshta rrëzohet nga sprova, tronditja e fatkeqësia më e lehtë apo për shkak të egos sonë.

Besimi i fortë dhe zemra e shndritshme e frenon egon, e ruan njeriun nga devijimi dhe sjelljet e pahijshme.

Gjithë çështja qëndron në punët e zemrës, së cilave u duhet kushtuar kujdes i veçantë para punëve të shqisave dhe gjymtyrëve, sepse nesër (në Ditën e Gjykimit):

“تُبْلَى السَّرَائِرُ”

“Do të zbulohen të fshehtat” (Et-Tarik: 9);

“وَحُصِّلَ مَا فِي الصُّدُورِ”

“Do të dalë në shesh ajo që është fshehur në gjokse”  
(El-Adijat: 10);

sepse nesër nuk shpëton nga dënimi i Allahut askush,

“إِلَّا مَنْ أَتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ”

“përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu”  
(Esh-Shuara: 89);

sepse nesër nuk do të hyjë në Xhenet askush,

“مَنْ حَشِيَ الرَّحْمَنَ بِالْغَيْبِ وَجَاءَ بِقَلْبٍ مُنِيبٍ”

“përveç atij që e ka pasur frikë të Gjithmëshirshmin, edhe atëhere kur nuk e shihte kush, e që ka ardhur me zemër të kthyer nga Allahu.” (Kaf: 33)

Në këtë botë distancat përshkohen me këmbë, ndërsa në botën tjetër përshkohen me zemër.

Vetëdukimi dhe ndërtimi i besimit nuk njohin kufij moshe, diturie, grade shkencore apo pozite shoqërore. Çfarë dobie ka dituria kur mungon edukimi?!

Allahu i Lartësuar i thotë prijësit të krijesave, njeriut më të devotshëm dhe të përkushtuar ndaj Tij, Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të):

“وَاعْبُدْ رَبَّكَ حَتَّىٰ يَأْتِيَكَ الْيَقِينُ”

**“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”** (El-Hixhr: 99)

Ebu Bekër Es-Sidiku nuk u ngrit në atë pozitë aq të lartë, të paarritshme nga të tjerët, nëpërmjet punëve të dukshme, por nëpërmjet punëve të padukshme të zemrës dhe të besimit që kishte në të.

Le ta ndërtojmë kështjellën e besimit dhe ta konsolidojmë atë. Të bëjmë kujdes nga kurthet e Iblisit.

Në kontekstin e asaj çfarë u përmend më lart, theksojmë se ndër veprat e pëlqyera është përmendja e Allahut pas namazit të sabahut derisa të lindë dielli. Është synet (vepër e pëlqyer) i transmetuar saktësisht në hadithet profetike. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) e kishte zakon dhikrin pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit. Kështu vepronin edhe shokët e tij dhe paraardhësit tanë të devotshëm. Kjo vepër lë gjurmë të pashlyera në besimin e njeriut dhe në edukimin shpirtëror të tij. Për ta arritur këtë virtyt njeriu duhet të luftojë me veten, sepse koha pas namazit të sabahut është kohë e gjumit dhe rehatisë, por edhe e punës dhe e shpërblimit. Prandaj, fëmijët dhe nxënësit duhet të edukohen me këtë vepër.

Paraardhësit tanë të devotshëm (Allahu i mëshiroftë) ishin të kujdesshëm ndaj këtij adhurimi, gjithashtu edhe njerëzit e përkushtuar që i pasojnë e kryejnë atë në mënyrë të rregullt. Në kohën tonë është nënvlerësuar kjo traditë profetike dhe në shumë xhami të muslimanëve ajo është braktisur, sikur të ishte diçka e huaj dhe e panjohur. Vetëm Allahut i kërkohet ndihmë!

Braktisja e kësaj tradite profetike është rezultat i shkaqeve të ndryshme. Kryerja e kësaj vepre lë gjurmë në besimin e njeriut.

## **Fehd bin Jahja El-Amari**

---

Vlerat e saj janë të shumta. Kjo vepër ka dispozita dhe rregulla që muslimani duhet t'i mësojë.

O njerëz të nderuar e fisnikë!

Kam kënaqësinë që në vazhdim t'ju prezantoj këtë përmbledhje që i kam bërë librit tim *“Beg’jetu el-mushtaki fi ehkami xhelsetu el-ishraki”* (botimi i parë). Libri që keni në duar ka ardhur si përgjigje e kërkesës së disa vëllezërve, të cilët këmbëngulën që ta përpunoj dhe ta shkurtoj librin e lartpërmendur, për ta lehtësuar leximin kështu që dobia e tij të jetë më e madhe. Për këtë arsye hoqa shumë opinione dhe argumente të juristëve islam. Ai që do të mësojë më shumë le të lexojë librin original dhe libra të tjerë të dijetarëve që trajtojnë këtë temë. Ky libër është pjesë e serisë së botimeve *“Zad”*.

Libri i parë i kësaj serie titullohet *“Zadu el-musafiri”*; libri original i tij është *“El-Muhteseru fi ahkami es-seferi”*.

Libri i dytë titullohet *“Zadu el-mu’temiri”*; libri original i tij është *“Et-Tuhfetu fi ahkami el-umrati uel-mesxhidi el-harami”*.

Libri i tretë titullohet *“Zadu es-saimi”*; libri origjinal i tij është *“Et-Tekribu ila mesaili es-sijami”*.<sup>5</sup>

I lutem Allahut që ta bëjë këtë libër të dobishëm për të gjithë njerëzit kurdoherë e kudo që ndodhen: në çdo kohë e në çdo vend; ta bëjë atë shpërblim të vazhdueshëm deri në Ditën e Gjykimit për mua, për prindërit e mi dhe për njerëzit e familjes sime; të më falë gabimet dhe të më mbulojë të metat; ta bëjë atë përjetësisht të bekuar.

---

5) Nuk është botuar ende.

I lutem Allahut që ta bëjë këtë libër pishtar që ndriçon zemrat; nëpërmjet tij të ngjallë zemrat e vdekura dhe të zgjojë zemrat e përgjumura; ta bëjë shkak shpëtimi dhe ilaç kurues, furnizim të begatë dhe rrezatim ndriçues në këtë botë dhe në botën tjetër për autorin e librit, për prindërit e tij, për njerëzit e shtëpisë së tij dhe për gjithë lexuesit e tij.

### **Agimi<sup>6</sup>**

Agimi e fton individin dhe ymetin që t'i kthehen Librit të Allahut dhe Traditës Profetike; ta studiojnë Shpalljen Hyjnore teorikisht dhe ta zbatojnë atë në praktikë. Vetëm në këtë mënyrë do të rikthejnë lavdinë dhe krenarinë e humbur.

Agimi i fton të gjithë që t'i kushtojnë rëndësi besimit monoteist, që ai të rrënjoset në zemër, të zbatohet në praktikë dhe ky besim të mbrohet me çdo mënyrë.

Agimi na fton që të marrim veten në llogari në rrugën tonë të udhëtimit drejt Allahut dhe botës tjetër.

Agimi na nxit të lexojmë biografinë e njerëzve të mirë dhe na frymëzon për t'iu përkushtuar adhurimit të Zotit të gjithësisë.

Agimi apelon për qëndrueshmëri në kohën e ndryshimeve e trazirave; apelon që t'i rezistojmë presionit të shoqërisë dhe të mos rendim drejt avancimit në karrierë.

Agimi apelon për rishikimin e metodës së edukimit tonë dhe të edukimit të atyre që kemi nën kujdestari, shtëpitë e shkollat tona, si dhe në të gjitha vatrat e edukimit dhe arsimimit.

Agimi brohoret: Kujdes, ruani ekuilibrin në veten tuaj dhe me

6) Autori ka për qëllim këtë libër. (shën. përkth.)

## **Fehd bin Jahja El-Amari**

---

të tjerët gjatë procesit të formimit shkencor, fetar dhe intelektual!

Agimi brohoret: Bëni kujdes ndaj adhurimit, sepse prej tij varet suksesi në këtë botë dhe në botën tjetër!

Agimi u pëshpërit me dashamirësi atyre që janë zhytur kokë e këmbë në kënaqësitë e kësaj bote, atyre që vrapojnë duke gulçuar prapa posteve si të çmendur, atyre që janë preokupuar me dynjanë dhe e kanë harruar botën e përjetshme, atyre që ndoshta e kanë humbur botën tjetër dhe e kanë shitur atë për shkak të kësaj bote.

Agimi na bërtet: Këshilloni njëri-tjetrin, këshilloni gjithmonë! Ngjalleni moralin e këshillës; veproni sipas udhëzimit profetik dhe sipas metodës së paraardhësve tanë të devotshëm!

Agimi bërtet: Mbani qëndrim ndaj shkelësve të ligjeve të Islamit, ndaj keqinterpretuesve të haditheve profetike, ndaj atyre që luajnë me lirinë e mendimit dhe me rendin e sigurinë!

Agimi brohoret: Mjaft, mjaft me grindjet dhe mosmarrëveshjet! Mos e humbisni kohën me thashetheme, me shkëmbim akuzash e shpifjesh të ndërsjella! Mos luani me nderin e muslimanëve! Mos qëlloni me thikë pas shpine! Larg egoizmit dhe vetëpëlqimit! Ne të gjithë do të dalim një Ditë para Allahut! Mjafton si fatkeqësi që ymetit islam i shkelet nderi dhe i pihet gjaku, i vritet virtyti dhe morali në sytë e botës!

Agimi bërtet: Morali, morali është shumë i rëndësishëm! Nëpërmjet tij lartësohen popujt dhe individët!

Agimi na bën thirrje që të kënaqemi dhe të kemi siguri për gjithçka që gjendet tek Allahu; të mbështëtemi tek Ai; të besojmë në atë çfarë u premton besimtarëve të sinqertë; të përhapim frymën e optimizmit e qetësisë; të largojmë pesimizmin dhe dëshpërimin.

Agimi bërtet: Fitorja do të arrihet pasi të rregullojmë zemrat dhe të pastrojmë shpirtrat, duke bërë të gjitha shkaqet legjitime!

Agimi na fton që të bëjmë kujdes me argumentimin në rastet e mosmarrëveshjeve që ekzistojnë mes dijetarëve për çështje të caktuara; të mos ndjekim dhe pasojmë lehtësimet e paargumentuara, duke u sjellë ndërmjet fetvave (verdikteve fetare) për të gjetur atë çfarë na pëlqen apo duke pasuar opinionet anormale, të dobëta e jokorrekte.

Kush ndjek tekat e veta, do të dëshpërohet. Kujdes mos u bëj laraman dhe i paqëndrueshëm. Feja e Allahut është një, unike dhe e pandryshueshme.

Agimi apelon që të bëjmë kujdes e të mos e marrim dijen nga të vegjëlit, nga ata që nuk kanë lidhje me diturinë, nuk kanë baza të qëndrueshme dhe nuk janë kompetentë. Agimi na fton që të ringjallim synetin e dhikrit pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit.

★ ★ ★



# **Kapitulli i parë**

*Parathënie për dhikrin pas namazit të sabahut deri në  
lindjen e diellit*

### **I. Përkufizimi i ishrakut (agimit) dhe koha e tij**

Ishraku (agimi) është drita e mëngjesit kur del dielli dhe nis të zbardhë dita.

Koha e ishrakut (e agimit) është kur lind dielli dhe shkëlqejnë rrezet e tij. Kjo është drita e parë e mëngjesit.

Me titullin e librit “LUTJET E AGIMIT” kemi për qëllim dhikrin pas namazit të sabahut derisa lind dielli. Këtë çështje do ta sqarojmë më pas, me lejën dhe vullnetin e Allahut.

### **II. Shembuj për kujdesin që tregonin paraardhësit tanë të mirë (Allahu i mëshiroftë) ndaj dhikrit pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit**

► Ibën Umeri (Allahu e mëshiroftë) pasi falte namazin e sabahut qëndronte në xhami duke e përmendur Allahun deri në lindjen e diellit. Kur e pyetën se përse vepronte kështu, ai u përgjigj: “Dua të zbatoj një synet.”<sup>7</sup>

► Tarik bnu Shihabi (Allahu e mëshiroftë) tregon se Abdullah bnu Mesudi pasi falte namazin e sabahut, nuk lejonte asnjë prej familjarëve të tij që të çohesh nga vendi i faljes derisa lindte dielli.<sup>8</sup>

► Vetë Ibën Mesudi ka thënë: “Nuk kam fjetur pas namazit të sabahut që kur jam bërë musliman.”<sup>9</sup>

► Euzai (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “Kur zbardhte agimi, paraardhësit tanë të mirë qëndronin në xhami, sikur mbi kokat

---

7) Ebu Euane nr.3463 dhe Ibën Shahini në librin “Et-Tergibu fi fedaili el-eamali” 46.

8) Ibën Ebi Shejbe në librin “El-Edebu” nr. 152.

9) Ibën Sadi në librin “Et-Tabekatu” (155/ 1).

e tyre rrinin zogjtë, nga përulësia e frikërespekti ndaj Allahut. Ata e përmendnin Allahun dhe merreshin me veten e tyre, pa e ndierë fare se çfarë kishin pranë. Sikur ndonjë i dashur i zemrës të largohej prej tyre, për një cast, e pastaj të kthehej sërish, atyre nuk u tërhiqte vëmendjen kjo gjë. Ata vazhdonin të ishin në këtë gjendje derisa afrohej koha e lindjes së diellit.”<sup>10</sup>

► Uelid bnu Muslimi (Allahu e mëshiroftë) tregon për Euzain se qëndronte në vendin ku falte namazin e sabahut duke e përmendur Allahun derisa lindte dielli. Ai thoshte se kështu vepronin njerëzit e devotshëm të Shekujve të Artë. Ata e përmendnin Allahun pas namazit të sabahut derisa lindte dielli. Pasi lindte dielli, çoheshin; pastaj vazhdonin ta përmendnin Allahun shumë dhe mësonin fenë e Tij.<sup>11</sup>

► Muhamed bnu Ahmed El-Atebi ishte njëri prej dijetarëve të shkollës juridike malikie. Pas namazit të sabahut ai qëndronte në vendfaljen e tij derisa lindte dielli; pastaj falte namazin e duhasë (të paradites).

Ata ishin njerëz me qëllime të pastra dhe të përkushtuar ndaj adhurimeve. Tek ata nuk ekzistonte egoizmi. Arritja e kënaqësisë së Allahut ishte çështja e tyre më madhore. Ata u larguan nga thashethemet, ishin asketë në dynja dhe i pastruan zemrat, sepse ambicia e tyre ishte rregullimi i botës dhe shpëtimi i njerëzimit. Ata u lidhën me qiellin (nëpërmjet lutjeve), prandaj bënë një jetë të këndshme në tokë. Historitë e tyre janë nga më të bukurat. Ata ishin si yjet në errësirën e natës; ishin si drita e agimit. O Zot, sa i bukur është udhëtimi me karvanin e njerëzve të mirë!

Gjendja jonë krahasuar me të tyren është sikurse thotë Ibën Kajimi (Allahu e mëshiroftë): *“Sa i përket atyre që janë në pararojë dhe më pranë Allahut, ne e kemi të vështirë të përshkruajmë gjendjen e*

10) Ubejdullah Ez-Zuhri në librin “Hadithu Ez-Zuhri” (521)

11) Sijer ealamu en-nubelai (114/7).

*tyre! Ne i kërkojmë falje Allahut, Atij përveç të Cilit nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë. Ne jemi larg këtyre dhe nuk e ndiejmë aromën e adhurimeve si ata. Gjithsesi, dashuria për ata njerëz na frymëzon që t'i njohim dhe të shpalosim vlerat e tyre, edhe pse kemi mbetur mbrapa dhe na copëtohet zemra për t'i arritur ata.”*

Ebu Naimi në librin e tij “*El-Hiljetu*” transmeton se Hasen El-Basriu ka thënë: “*Besimtari e di që në këtë botë është i përkohshëm. Ai punon për hir të Allahut në këto pak ditë. Për Zotin, ai nuk ka brengë begatitë dhe kënaqësitë e kësaj bote. Ai e sheh dynjanë me nënçmim dhe i shfrytëzon begatitë e saj për të fituar përjetësinë. Këtë botë nuk e konsideron si shtëpinë e vet, ku njeriu gjen prehje e qetësi; nuk lakmon në kënaqësitë e saj dhe nuk gëzohet me begatitë e saj. Nëse e godasin fatkeqësitë, ai nuk dëshpërohet, por bën durim duke shpresuar në shpërblimin e Allahut. Nuk ka për qëllim këtë botë kalimtare; në të jeton me ndjenjën e frikës dhe të shpresës duke e adhuruar Allahun me përkushtim. Urime, urime për këtë njeri! Allahu do ta sigurojë nga frika dhe paniku, do t’ia mbulojë të metat dhe do t’ia lehtësojë llogarinë (në Ditën e Gjykimit). Njerëzit e mençur prej muslimanëve thoshin: “O biri i Ademit, asgjë të mos të dekurajojë nga veprat e mira. Njeriu shpëton atëhere kur hyn në Xhenet, të cilin Allahu ua ka premtuar besimtarëve. Allahu nuk e thyen premtimin e Tij. Xheneti nuk fitohet me iluzione. Kush shpreson pa bërë vepra të mira, është i vetëmashtruar.”<sup>12</sup>*

### **III. Shkaqet pse njerëzit e kanë braktisur synetin e përmendjes së Allahut pas faljes së namazit të sabahut deri në lindjen e diellit**

1. Besimi dhe motivimi i dobët.

2. Ibën El-Xheuzi thotë: “*Duke medituar për shkakun që e ngre njeriun në lartësinë e virtyteve, gjeta se është ambicia e lartë.”*

---

12) “*Hiljetu el-eulijai*” (146/2).

3. Gjynahet, të cilat e pengojnë njeriun nga veprat e mira. Sa gjynahe ia vështirësojnë njeriut veprat e mira dhe e privojnë atë nga namazi i natës dhe përmendja e Allahut?!

4. Shkujdesja, përtacia dhe dobësia në aspektet e adhurimit me të cilat janë sprovuar shumë individë të shoqërisë islame. Këtu kemi për qëllim nënvlerësimin e veprave të pëlqyera vullnetare. Njeriu duhet të bëjë përpjekje të forta në rrugën drejt përsosmërisë shpirtërore. Udhëtimi është i gjatë dhe i vështirë, ndërsa furnizimi është i pakët. Allahu i Lartësuar thotë:

“وَالَّذِينَ جَاهَدُوا فِينَا لَنَهْدِيَنَّهُمْ سُبُلَنَا وَإِنَّ اللَّهَ لَمَعَ الْمُحْسِنِينَ”

**“Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët!” (El-Ankebut: 69)**

5. Rendja pas qejfeve dhe kënaqësive të kësaj bote. Luksi dhe kënaqësitë e tepruara ia rëndojnë njeriut veprat e mira.

6. Agimi është kohë gjumi e rehatie për njerëzit, çfarë i bën ata që ta neglizhojnë vlerën e kësaj kohe.

7. Kalimi i natës pa gjumë është një fenomen mjaft i përhapur ndër njerëzit e grupeve dhe kategorive të ndryshme. Ky fenomen përsëritet shpesh dhe te disa njerëz është i përhershëm, gjë e cila ua vështirëson shumë detyra dhe vepra vullnetare, ua humbet kohën në gjëra që nuk u bëjnë dobi as për këtë botë dhe as për botën tjetër.

Ibën Kajimi thotë: *“Ajo çfarë kërkohet prej teje është që të kujdesesh për shëndetin tënd shpirtëror, për kohën tënde dhe për raportet e tua me Allahun. Askujt mos i jep përparësi para fesë së Allahut. Nëse të shmang diçka prej fesë së Tij, dije se je duke ndjekur shejtanin në mënyrë të pa vetëdijshme.”*

## **Fehd bin Jahja El-Amari**

Njerëzit ndiejnë kënaqësi me kalimin dhe humbjen e kohës; duket sikur janë aktivë në kotësi. Pikërisht, atëhere kur vjen koha e fladit, e bereqetit dhe e ardhurimit, shpirtrat mërziten, zemrat rëndohen, vijnë shfaqësimet dhe dalin punë të tjera më parësore se adhurimet. Ndërkohë, njerëzit parapëlqejnë takimet, fjalët, rehatinë dhe gjumin. Vetëm Allahut i ankohe mi për dobësinë e vendosmërisë sonë në rrugën e Tij!

Disa njerëz pasi falet namazi i sabahut dalin nga xhamia dhe ulen jashtë saj, duke u marrë me thashetheme deri afër kohës kur lind dielli. Kjo është humbje, për të mos thënë dëshpërim i qartë. Allahut i kërkojmë strehim nga privimi dhe braktisja!

8. Shfaqja e një mungese të theksuar serioziteti ndaj botës tjetër dhe mospërgatitja për të.

9. Angazhimet, mbledhjet dhe takimet e shumta që nuk kanë rëndësi.

10. Mungesa e ndërgjegjësimit për nevojën që ka njeriu për ta përmendur Allahun në kohën e agimit.

11. Vështirësia e vetëkontrollit dhe nënshtrimit të vetes në bindjen ndaj Allahut.

12. Polemika me të cilën janë sprovuar shumë njerëz në jetën e tyre, veçanërisht në forumet e ndryshme. Për shkak të saj janë privuar nga shumë adhurime dhe diturinë nuk e vënë në jetë. Prej saj zemra ngurtësohet dhe lind urrejtja e armiqësia.

*Euzai thotë: “Kur Allahu nuk e do një popull, e lë atë të merret me polemikë dhe e privon nga puna.”*

*Imam Maliku thotë: “Kur futet polemika në dituri, e ngurtëson zemrën dhe nxit urrejtjen e armiqësinë.”*

13. Njerëzit janë lidhur shumë me punët dhe profesionet e

tyre. Sikur muslimani ta programonte kohën dhe pushimin javor, kjo do të ishte një mirësi e madhe për të.

14. Performanca e dobët e atyre që duhet të jenë shembull për ringjalljen e synetit të qëndrimit në vendfalje pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit, me qëllim përmendjen e Allahut dhe faljen e namazit të ishrakut (agimit).

15. Mungesa e dijes për vlerën e veprave të mira dhe mosnjohja e biografisë së njerëzve të mirë. Njohja e biografisë së tyre i lartëson ambiciet, e largon të keqen nga zemra dhe e bën njeriun që të ketë turp prej Allahut.

16. Disa prej nesh nuk e madhërojnë Traditën Profetike dhe nuk e ndjekin Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).<sup>13</sup>

17. Mungesa e integritetit dhe e mosbalancimit gjatë procesit të edukimit. Paraardhësit tanë të mirë dhe dijetarët e mëdhenj ishin të kompletuar në çdo aspekt. Ndërsa sot ka njerëz që ndjekin rrugën e dijes apo të thirrjes në fenë e Allahut, mirëpo

---

13) Dikur njerëzit garonin në praktikimin e Traditës Profetike në aspektin e adhurimit, të veshjes, të ushqimit dhe këshillimit. Ndërsa në kohën tonë ka dalë një grup - Allahu i udhëzoftë dhe i ktheftë te e vërteta - që u bën thirrje njerëzve të heqin dorë nga shumë praktika të Traditës Profetike. Shkak për këtë mund të jetë metodologjia e gabuar, ose argumentohen me presionin e realitetit, ose është një lloj kundërpërgjigje ndaj disa rrymave apo individëve. Sipas tyre, praktikimi i synetit tërheq vëmendjen e të tjerëve dhe e vë në pozitë të vështirë vetë personin që e praktikon. Në fakt, kjo u erdhi përshtat disa njerëzve zemërdobët që kanë pësuar disfatë shpirtërore, që kanë mangësi në vetëdukim, që kanë formim të brishtë botkuptimor, prej masës së gjërë së njerëzve, prej të rinjëve në moshë dhe pseudo-intelektualëve. Ata pasojnë të paqëndrueshmë dhe dështakët, që kanë devijuar pasi nënvlerësuan parimet bazë të Islamit dhe Traditën Profetike me arsyetime të dobta. Ata përvetësuan ide të gabuara dhe, për pasojë, u rrëzuan. Në fakt, rrëzimi është i lehtë, ndërsa ngritja është e vështirë. Ymeti islam ka pasur dhe do të vazhdojë të ketë mirësi. Flamuri i synetit është ngritur dhe duket qartë. Mirëpo, realiteti duhet pranuar ashtu siç është, sepse në këtë mënyrë shkojmë drejt përmirësimit. Mbulimi i gabimeve mund të shkaktojë përsëritjen e tyre dhe përqesimin e gjendjes.

## **Fehd bin Jahja El-Amari**

kanë mangësi të theksuar në aspektin e adhurimeve. Disa të tjerë i përkushtohen adhurimeve, por kanë magësi të theksuar në dituri, ndoshta janë krejt të paditur.

Rrjedhimisht, rezultati është ky:

- Mungesë e theksuar në përmirësimin e vetes dhe nënvlerësim i punëve të zemrës.

- Mangësi e madhe në jetën e shumë njerëzve në raportet e tyre me veten dhe me të tjerët.

- Defekte të mëdha në moral, sidomos në problemet me mungesën e ruajtjes së gjuhës dhe pastërtisë së fjalorit. Nuk është për t'u habitur: shumë njerëz tregojnë devotshmëri në aspektin e të ushqyerit, mirëpo gjuhën e lëshojnë pa frërë, duke i përgojuar njerëzit nga mëngjesi deri në mbrëmje me arsye të dobëta. Atyre nuk u bën dobi asnjë aluzion. Ata nuk i ndal asnjë predikim dhe nuk i zgjon asnjë këshillë.

- Problemet në konceptimin e marrëdhënieve financiare çuan në marrjen në konsideratë të interpretimeve të pasakta dhe të lehtësimeve anormale.

- Çrregullime dhe paqëndrueshmëri për shkak të sprovave, të krizave të vazhdueshme, telasheve e fatkeqësive të njëpasnjëshme.

- Disa misionarë fetarë, kërkues të dijes, edukatorë e prindër kanë defekte në mënyrën se si edukojnë ata për të cilët kanë përgjegjësi për edukimin e tyre.<sup>14</sup>

- Vetëmashtrimi dhe vetëkënaqësia.

---

14) Shumë njerëz i përkushtohen kërkimit të ditorisë dhe memorizimit të

## **Të dashur predikues dhe edukatorë!**

Ne duhet të vendosim patjetër një ekuilibër mes kërkit të dijes dhe edukimit shpirtëror. Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta) thoshin: “Mësuam diturinë, pastaj Kuranin.”

Xhundubi (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë:

*“Në kohën e Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ishim në kulmin e rinisë. Ne e mësuam besimin, para se të mësonim Kuranin. Pasi e mësuam Kuranin, nëpërmjet tij e shtuam besimin.”*<sup>15</sup>

Në një transmetim tjetër: “Ndërsa ju sot e mësoni Kuranin para besimit.”<sup>16</sup>

Abdulla bnu Umeri (Allahu e mëshiroftë) ka thënë:

*“Në kohën tonë merrej besimi para Kuranit. Kur Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i shpallej ndonjë sure, ne mësonim prej saj çfarë lejohet, çfarë ndalohet dhe cilat janë kufijtë e Allahut, ashtu siç e mësoni ju sot Kuranin. Sot shoh njerëz që e mësojnë Kuranin para besimit. E lexojnë Kuranin nga fillimi deri në fund dhe nuk dijnë urdhrat dhe ndalesat e tij, nuk i njohin kufijtë e tij.”*<sup>17</sup>

Hudhejfja (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: “Ne jemi njerëzit që na u mësua besimi para Kuranit. Ndërsa juve keni mësuar Kuranin para besimit.”<sup>18</sup>

---

sentencave, marrin diploma të niveleve të larta ku janë regjistruar notat më të mira, mirëpo kanë defekte të mëdha në aspektet e lartpërmendura. Atëhere, ku është dobia e diturisë dhe ku janë frytet e saj?! Dituria është rruga që çon drejt përsosmërisë shpirtërore. Çfarë dobie ka memorizimi i sentencave, përvetësimi i njohurive dhe diplomat, nëse nuk lënë gjurmë në zemrat e gjuhët tona, në moralin dhe në jetën tonë?!

15) Ibën Mende në librin “Kitabu el-imani” nr.208.

16) Bejhëki në librin “Es-sunenu el-kubra” nr. 5292.

17) Ibën Mende në librin “Kitabu el-imani” nr.207; gjithashtu e transmeton Hakimi dhe e ka saktësuar Dhehebiu nr.101.

18) Bejhëki në librin “Es-sunenu el-kubra” nr. 5291

Ne duhet të rrënjosim besimin e drejtë, që të rregullohet jeta jonë në këtë botë dhe në botën tjetër.

18. Prej shkaqeve të braktisjes së synetit të dhikrit pas sabahut deri në lindjen e diellit është dhe dallimi që bëhet ndërmjet qëndrimit në vendin e faljes pas sabahut - i cili është i ligjësuar unanimisht - dhe haditheve që janë transmetuar për vlerën e qëndrimit në vendfalje, me qëllim faljen e namazit të ishrakut (agimit) pas lindjes së diellit. Për këto hadithe dijetarët ndajnë opinione të ndryshme, sa i përket saktësisë së tyre. Kjo ka bërë që shumë njerëz të nënvlerësojnë këtë vepër të mirë. Sa për debat, le të supozojmë se nuk ka argumente të sakta për vlerën e qëndrimit në xhami pas namazit të sabahut, me qëllim përmendjen e Allahut deri në lindjen e diellit. Përtej kësaj, vepra në fjalë ka ndikim të madh në përmirësimin e zemrës dhe pastrimin e shpirtit. Prandaj, dijetari dhe nxënësi i dijes kur jep fetva (verdikte fetare) apo e shqyrton çështjen duhet ta shohë atë në nivel gjithëpërfshirës dhe të tregohet largpamës. Kur për një çështje të caktuar dijetarët ndajnë opinione të ndryshme, disa thonë se “është synet”, disa të tjerë “vaxhib” dhe të tjerë thonë se “është e lejuar”, përtej këtij mjedisi akademik ne duhet t'i nxisim njerëzit që të bëjnë vepra të mira dhe të kapen fort në fenë e Allahut; të bëhemi shkak që ata të fitojnë shpërblime dhe të përmirësojnë zemrat. Shqyrtimi i çështjes të mos jetë rezultat i reagimeve momentale apo i presionit të realitetit.

Disa njerëz kanë qenë të kujdesshëm në zbatimin e këtij syneti dhe më pas faljen e namazit të ishrakut (agimit), mirëpo pasi kanë dëgjuar opinionin e atyre që thonë se nuk ka hadithe të sakta për këtë vepër, e kanë braktisur këtë synet dhe janë kthyer në shtëpitë e tyre për të fjetur gjumë. Dikur, pas namazit të sabahut, xhamitë kanë qenë të mbushura me muslimanë, të rinj e të moshuar, në sezone të ndryshme, e sidomos në Ramazan, në ditët e pushimeve dhe në

10-ditëshin e parë të Dhul hixhes. Ndërsa në kohën tonë kjo traditë profetike duket si e huaj dhe vetëm Allahut i kërkohet ndihmë!

19. Shqyrtimi juridik jokorrekt i kësaj çështjeje nga disa nxënës të dijës ka ndikuar në braktisjen e këtij syneti. A thua se për vlerën e këtij syneti nuk ka argumente?! A thua se shumë dijetarë të mëdhenj, prej ekspertëve të hadithit dhe jurisprudencës islame, realistë e studiues të mirëfilltë nuk kanë folur për vlerat e këtij syneti?!<sup>19</sup> Përse disa e shohin si diçka jo normale?! Ti habitesh kur sheh disa të rinj në rrugën e kërkimit të diturisë që tregohen fanatikë dhe të ashpër, sa i përket qëndrimit ndaj haditheve që flasin për vlerat e veprave të mira. Dy rekatet që falen pas lindjes së diellit ata i quajnë “*namazi i të moshuarve*”, duke e përcjellë atë si opinion të disa dijetarëve të mëdhenj.<sup>20</sup>

Përtej kësaj, superinjorancë është ajo e disa njerëzve që mendojnë se dhikri pas sabahut deri në lindjen e diellit është vepër e bidatçinjëve (atyre që sjellin risi në fe)!

20. Mungesa e hetimit të dallimeve ndërmjet adhurimeve. Tekstet e sheriatit e nxisin njeriun që të kërkojë të bëjë më të mirën e mundshme, sepse zemrat i admirojnë veprat e mira. Sahabët e pyesnin shpesh Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi

---

19) Sa i përket çështjeve për të cilat ka mosmarrëveshje, njerëzit mund të kategorizohen në tre grupe: dy janë ekstreme dhe i treti është i mesëm.

Disa i pranojnë të gjitha mendimet ndryshe, pavarësisht të qenurit mendime të forta, të dobëta apo anormale. Disa të tjerë i refuzojnë të gjitha mendimet ndryshe; nuk e pranojnë diversitetin e mendimeve dhe opinionin e tjetrit, edhe nëse ai është i fuqishëm dhe i rëndësishëm. Mesatarizmi është i kërkuar, që do të thotë se duhet të merret në konsideratë mendimi i saktë dhe të refuzohet i dobëti dhe anormali. I suksesshëm është ai të cilit Allahu i jep sukses.

20) Grindja dhe përçarja për shkak të mendimeve ndryshe është rezultat i injorancës, i imitimit të verbër e fanatik. Armiqësinë e ndezin injorantët fanatikë dhe jo dijetarët e studiuesit e mirëfilltë.

të): *“Cila vepër është më e mirë?”*

Izu Abduselami ka thënë: *“Allahu i ka bërë robërit e tij të prirur drejt më të mirës dhe kërkues të idealeve. Vetëm një idiot, ose ai që nuk ka dije për rendin e përparësisë zgjedh atë që është më e dobët, duke i dhënë prioritet ndaj asaj që është më e mirë. Kështu vepron vetëm një i dëshpëruar që nuk e njeh më të mirën, më të lartën.”*

### **IV. Gjurmët që lë në besimin e njeriut dhikri pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit**

1. Fitimi i shpërblimit përmes kryerjes së synetit dhe pasimit të Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

2. Vetëkontrolli dhe ushtrimi i vetes me dhikër duke u përpjekur që zemra të jetë tërësisht e përqëndruar për ta kryer këtë vepër sa më mirë. Dhikri nuk i jep frytet e veta dhe njeriu nuk mund ta shijojë atë pa e angazhuar gjuhën dhe pa u përqëndruar me mendje e zemër që ta ndjejë atë çfarë artikulon me gjuhën e vet.

3. Largimi nga thashethemet dhe mjetet e komunikimit, të cilat i kanë dobësuar zemrat dhe i kanë angazhuar mendjet. Ato janë bërë një fenomen shqetësues i përhershëm dhe i pandërprerë. Sigurisht, tërheqja në vetmi duke iu bindur Allahut është një ndër arsyet më të forta për t’u kujdesur ndaj vetes, duke e çuar atë drejt përmirësimit të vazhdueshëm përmes autokritikës.

4. Edukimi shpirtëror. Njeriu ka nevojë që ta ushtrojë veten për të fituar shprehitë e duhura e të dobishme; ta mësojë atë me vepra të mira dhe të bëjë përpjekje të mençura në rrugën drejt pastrimit shpirtëror, në mënyrë që shpirti i tij të lartësohet në këtë botë dhe në botën tjetër.

5. Prehja e qetësia e zemrës, përmirësimi i të metave dhe pastrimi

i saj nga njollat e gjynaheve, që janë rezultat i përzjerjes së tepruar me njerëzit dhe i përdorimit pa kriter të mjeteve të komunikimit bashkëkohor, të cilat kanë efekt çoroditës. Zemra ka nevojë për trajnim intensiv të përditshëm që të pastrohet dhe të ripërtërihet. Shoqërimi i tepruar me njerëzit e rëndon dhe e ngurtëson zemrën, çfarë e bën nevojë imediate trajtimin e saj të përditshëm. Ndër ilaçet më të mira është dhikri pas sabahut dhe falja e namazit të ishrakut (agimit), të cilat e ripërtërijnë, i japin asaj gjallëri, shkëlqim dhe fuqi. Për këtë arsye, paraardhësit tanë të mirë, dijetarët dhe adhuruesit e përkushtuar ishin mjaft të kujdesshëm ndaj punëve të zemrës.

A do të ketë reflektim dhe bashkëpunim për ringjalljen e këtij syneti në shtëpitë e Allahut?! A do të këshillojmë njëri-tjetrin dhe do të garojmë në këtë vepër të mirë?!

A ka ardhur koha që të zbuten zemrat tona dhe t'i jepemi me gjithë shpirt këtij adhurimi?! Kur do të largohemi nga preokupimi me takimet e shumta dhe ruhem nga varësia e rrjeteve sociale?!

A ka ardhur koha që të largojmë mendjen e zemrën tonë, shpirtin, shikimin dhe dëgjimin tonë nga zhurma e rrjeteve sociale dhe të shijojmë kënaqësinë e adhurimit, të dhikrit, të namazit dhe të leximit të Kuranit?!

Shkujdesja ndaj përmendjes së Allahut është shkaku më i fortë që e ngurtëson zemrën, e shkreteton dhe e largon atë nga veprat e mira; ndërsa përmendja e Allahut është shkaku më i fortë për ringjalljen dhe ndriçimin e saj. Kur mediton për ata që i janë përkushtuar dhikrit arrin të zbulosh sekretin përse u buzëqesh jeta dhe janë të kënaqur me të. Në fytyrat e tyre lexohet qartë qetësia dhe lumturia. Sa të bukura janë ato fytyra! Sa të mrekullueshme e të përsosura janë ato shpirtra! Kurrë nuk do të lodhesh nga shoqërimi me ta, sepse ata ta mbushin shpirtin plot me kënaqësi,

të bëjnë optimist për jetën dhe të sjellin prehje e qetësi.

Le të veçojmë një pjesë të kohës sonë për të qëndruar pranë tyre, qoftë edhe pak, sepse ata na kujtojnë Zotin e krijesave. Kështu vepronin paraardhësit tanë të mirë (Allahu i mëshiroftë).

6. Kur besimtari ulet të përmendë Allahun pas namazit të sabahut, gjithë pjesa tjetër e ditës së tij do të jetë e bekuar; zemra forcohet dhe trupi gjallërohet; njeriu aftësohet për të përballuar problemet dhe vështirësitë.

Ibën Tejmija (Allahu e mëshiroftë) e përmendte shumë Allahun pas namazit të sabahut derisa zbardhte agimi. Ai nuk i fliste askujt dhe nuk i interesonte asgjë tjetër përveç dhikrit. Pasi e përfundonte dhikrin thoshte: *“Ky është ushqimi im i mëngjesit. Nëse nuk e marr këtë ushqim, nuk do të kem fuqi.”* Ai nuk i thoshte këto fjalë me hamendësi apo nga fantazia e vet, por fliste për diçka që e ndiente çdo ditë me zemër dhe me tërë qenien e tij. Kjo ishte një ndër shkaqet e formimit të personalitetit të tij brilant në dituri dhe ndër sekretet më të rëndësishme të sukseseve të tij. Me këtë fuqi shpirtërore, mendore dhe shkencore ai i ka mahnitur mendjet dhe i ka qetësuar shpirtat e njerëzve që trashëgojnë diturinë e tij.

Në librin *“El-uabilu es-sajibu”* Ibën Kajimi rëndit dobisë e dhikrit. Ai shkruan: *“Përmendja e Allahut ka 61 dobi. Një ndër vlerat më të mëdha të dhikrit është se ai i jep fuqi njeriut. Kur njeriu e përmend Allahun, mund të bëjë atë çfarë nuk ia merr mendja se mund ta bënte. Unë kam parë te Ibën Tejmija një fuqi të jashtëzakonshme, në veprat dhe në fjalët e tij, në krijimtarinë dhe në produktivitetin e tij. Ai shkruante në një ditë aq sa dorëshkruesi e bënte në një javë, madje dhe më shumë”.* Vërtet ata ishin njerëz shumë të devotshëm dhe të përkushtuar ndaj Allahut. Vetëm adhuresit e sinqertë të Allahut, ata që janë të

zellshëm në adhurime dhe e përmendin shumë Zotin e gjithësisë, vetëm këta mund të përballojnë vështirësitë e thirrjes në fenë e Allahut, t'i mësojnë njerëzit, të plotësojnë nevojat e tyre dhe të jenë durimtarë e të vazhdueshëm në vepra të mira. Allahu i Lartësuar thotë:

وَجَعَلْنَاهُمْ أُمَّةً يَهْدُونَ بِأَمْرِنَا وَأَوْحَيْنَا إِلَيْهِمْ فِعْلَ الْخَيْرَاتِ وَإِقَامَ الصَّلَاةِ وَإِيتَاءَ  
الزَّكَاةِ وَكَانُوا لَنَا عَابِدِينَ

“Ne i bëmë ata udhëheqës që udhëzonin sipas urdhërit Tonë dhe i frymëzuam që të bënin vepra të mira, të kryenin faljet dhe të jepnin zeqatin, dhe ata vetëm Ne na adhuruan.” (El-Enbija: 73)

فَاسْتَجَبْنَا لَهُ وَوَهَبْنَا لَهُ يَحْيَىٰ وَأَصْلَحْنَا لَهُ زَوْجَهُ إِنَّهُمْ كَانُوا يُسَارِعُونَ فِي  
الْخَيْرَاتِ وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا وَكَانُوا لَنَا خَاشِعِينَ

“Me të vërtetë, ata nxitonin për vepra të mira dhe Na luteshin, me shpresë e frikë, si dhe ishin të përrulur ndaj Nesh.” (El-Enbija: 90)

Thirrja në fenë e Allahut, mësimi i njerëzve dhe përpjekja për të plotësuar nevojat e tyre nuk i pengoi ata nga adhurimi i Allahut gjatë natës dhe ditës; as që bëhet fjalë se mund të pengoheshin nga pasuria, nga gratë dhe fëmijët e tyre. Çfarë mund të thuhet për bisedat e kota, për thashethemet, për shpifjet ndaj njerëzve të nderuar e fisnikë, për humbjen e kohës deri në mesnatë, që ndoshta zgjat deri para agimit përmes mjeteve të komunikimit dhe kështu me radhë...?!

► **Njëri prej durimtarëve ka thënë:** “Kur kam qenë tetë vjet në burg, asnjëherë nuk e kam lënë dhikrin pas sabahut dhe namazin e ishrukut (agimit). Kjo ishte një ndër faktorët më të fuqishëm që më bëri

*të durueshëm në përballimin e vështirësive.”*

Është transmetuar në hadith: *“Kujt i hapet porta e mirësisë le ta shfrytëzojë atë, sepse nuk e di se kur do t'i mbyllet ajo.”*<sup>21</sup>

► **Transmetohet se Zubejri (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë:** *“Ai që ka mundësi të veçohet në ndonjë vend të fshehtë për të bërë ndonjë vepër të mirë, le ta bëjë atë.”*<sup>22</sup>

Sa njerëz të mirë – që gjenden mes nesh – e jetojnë jetën si të devotshmit e Gjeneratës së Parë; janë si ata në namazin dhe agjërimin e tyre, në adhurimin dhe moralin e tyre?!

Njëri prej dijetarëve të devotshëm agjëron prej 10 vitesh një ditë po e një ditë jo; e lexon Kuranin e plotë në çdo tri ditë; falet në një të tretën e fundit të çdo natë, i lutet Allahut dhe kërkon falje prej Tij.

Sa njerëz të mirë prej vitesh nuk e lënë dhikrin pas namazit të sabahut deri në agim?!

Njëri prej njerëzve të zgjedhur ka shtatë vite që agjëron ditën e enjte dhe bën dhikër pas namazit të sabahut deri në agim. E veçon këtë ditë për shkak të vlerës që ajo ka. E enjtja është dita kur hapen portat e Xhenetit<sup>23</sup> dhe paraqiten (ngrihen) punët tek Allahu.<sup>24</sup>

Disa besimtarë pasi dalin në pension i gjen gjithmonë në xhami, duke e përmendur Allahun pas namazit të sabahut deri në agim dhe ndërmjet namazit të akshamit e jacisë. Kjo sepse në xhami gjejnë kënaqësi e lumturi, prehje e qetësi, duke u tërhequr në vetmi për të përmendur Allahun dhe për të përmirësuar zemrën. Ata largohen nga çdo gjë që ua prish zemrën dhe ua dëmton fenë, duke mos u përzierë me njerëz të ligj e kështu me radhë...

---

21) Libri “Ez-Zuhdu ue err-rrakaiku” i Ibën Mubarekut nr.435.

22) Transmeton Nesaiu në librin “Es-Sunen el-kubra”

23) Transmeton Muslimi nr.35.

24) Transmeton Muslimi nr. 36.

A do të ketë reflektim dhe bashkëpunim për ringjalljen e këtij syneti në shtëpitë e Allahut?! A do të këshillojmë njëri-tjetrin dhe do të garojmë në këtë vepër të mirë?!

Gjendja jonë është ashtu siç ka thënë Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të): “Ne e kemi humbur shpërblimin e shumë veprave të mira!”

► **Ibën Kajimi thotë:** “*Dynjaja është pistë garimi. Njerëzit garojnë në të me shpejtësi të ndryshme: dikush me shpejtësinë e kalorësit, një tjetër si këmbësor dhe tjetri si të ketë hipur mbi gomar.*”

► **Ibën Rexhepi thotë:** “*Në kohën kur Ibën Kajimi qëndroi në Mekë, banorët e saj habiteshin nga adhurimi i fortë dhe tauafi i shpeshtë që ai bënte në Qabe.*”

Misioni dhe objektivi ynë në këtë botë është madhor: ta adhurojmë Allahun Një e të Vetëm, pa i shoqëruar ortak, ta adhurojmë ashtu si dëshiron Ai, me namaz, zekat, agjërim, haxh, sadaka, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja.

### **Motivet më të forta për realizimin e ambicieve:**

1. Të shoqërohesh me njerëz të mirë, të devotshëm e të përkushtuar ndaj adhurimit të Allahut. Kur i sheh ata të kujtojnë Allahun dhe botën tjetër, të frymëzojnë për vepra të mira, të kujtojnë Brezin e Parë të muslimanëve; ti mëson prej tyre dhe i pason ata.

Njëri prej tyre thotë: “*Kur jam ndjerë i plogët në adhurime, kam parë gjendjen e Muhamed bnü Uasiut dhe zellin e tij, e kjo më ka frymëzuar e më ka shtuar zellin për një javë.*”

2. Nëse, në kohën dhe vendin ku jeton, nuk gjen njerëz si ata për t’u shoqëruar dhe të mungon ky motivim, atëherë lexo dhe dëgjo rreth historisë së paraardhësve tanë të devotshëm. Duke dëgjuar

historitë e tyre, të ngrihet morali, aktivizohen ndjenjat pozitive dhe zemra zgjohet nga pakujdesia.

3. Shpirtrat dobësohen, lodhen e mërzhiten – përveç shpirtrave të atyre që i ndihmon Allahu –, prandaj kanë nevojë për këshilla që të largohet pluhuri prej tyre, të vihet në lëvizje e të shkojnë përpara.

Në *“Sahihun e Buhariut”* transmetohet se Ebu Uaili ka thënë: *“Abdullah bnu Mesudi i përkujtonte dhe i këshillonte njerëzit një herë në javë, çdo të enjte. Dikush i tha: ‘O babai i Abdurrahmanit, dëshirojmë që të na përkujtosh dhe të na këshillosh çdo ditë!’ Ai tha: ‘Ajo çfarë më pengon është se unë e urrej që të bëhem i bezdisshëm për ju. Unë ju përkujtoj dhe ju këshilloj herë pas here, ashtu siç vepronte i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) me ne nga droja se mos na mërzhiste.”*<sup>25</sup>

### **V. Gjykimi për gjumin pas namazit të sabahut është subjekt i mosmarrëveshjeve mes dijetarëve (Allahu i mëshiroftë)**

Mendimi i parë: Gjumi pas namazit të sabahut nuk është i pëlqyer, për shkak të vlerës të veçantë që ka kjo kohë. Ky është mendimi i shumë juristëve islam. Në *“Sahihun e Muslimit”* transmetohet se Ebu Uaili- vëllai i Ibën Seleme El-Esedi – ka thënë: *“Një ditë pas namazit të sabahut i shkuam për vizitë në shtëpi Abdullah bnu Mesudit. Trokitëm në derë dhe ai na dha lejë të hynim. Për një moment të shkurtër, qëndruam tek dera. Ndërkohë, një vajzë e vogël doli dhe tha: ‘Përse nuk hyni?’ Pastaj hymë në shtëpi. Atje e gjetëm Abdullahin ulur duke përmendur Allahun. Ai tha: ‘Çfarë ju pengoi të futeni në shtëpi, ndërkohë që ju ishte dhënë leja?’ I thamë: ‘Ne menduam se ndoshta disa nga familjarët e tu do të ishin në gjumë.’ Ai tha: ‘Ju menduat se familjarët e mi janë të shkujdesur?!’ Pastaj vazhdoi të përmendte Allahun derisa mendoj se kishte lindur dielli. E urdhëroi vajzën të shihte diellin. Ajo vërejtj se dielli nuk kishte dalë akoma. Ai vazhdoi përsëri*

---

25) Buhariu 70

*ta përmendte Allahun derisa mendoj se dielli kishte lindur. Përsëri e urdhëroi vajzën të shihte diellin. Ajo e pa diellin dhe e njoftoi për këtë. Abdullahu tha: “E falenderoj Allahun që na solli këtë ditë të re dhe nuk na shkatërroi për shkak të gjynaheve tona.”<sup>26</sup>*

Hisham bnu Uruetu transmeton se babai i tij ka thënë që Zubejri i ndalonte djemtë e vet nga gjumi pas namazit të sabahut. Urua ka thënë: “Kur unë marr vesh që një person fle pas namazit të sabahut, kam rezerva ndaj tij.”<sup>27</sup>

Ibën Kajimi ka thënë: “Ata e konsiderojnë të papëlqyer gjumin në kohën ndërmjet namazit të sabahut dhe lindjes së diellit, sepse kjo është koha e fitimit të shpërblimeve. Për udhëtarët në rrugën e Allahut koha pas namazit të sabahut është shumë e çmuar. Edhe kur udhëtojnë gjatë gjithë natës, nuk ja lejojnë vetes ndalesën dhe uljen në këtë kohë derisa të lindë dielli.”

**Mendimi i dytë:** Nuk është i urryer gjumi pas namazit të sabahut, sepse nuk ka argument që ta bëjë të tillë. Ky mendim është transmetuar nga disa prej paraardhësve tanë të nderuar.

Mund të thuhet se të parët tanë të nderuar kanë vepruar ndryshe nga çfarë tregohet për ta. Ajo çfarë është transmetuar prej tyre, në përkrahje të këtij mendimi mund të jetë ndonjë rast i izoluar dhe për shkaqe të caktuara.

Faktikisht, nuk thuhet se gjumi pas namazit të sabahut është i urryer, sepse *el-kerahatu* (urrejtja) është gjykim sheriatit dhe ka nevojë për argument. Mirëpo, nuk ka dyshim se ai që fle pas namazit të sabahut ka lënë pa bërë disa vepra të mira. Lënia e veprave të pëlqyera nuk do të thotë se patjetër ka bërë vepra të

26) Muslimi 278.

27) “Musanefu Ibën Ebi Shejbe” 222/5.

## **Fehd bin Jahja El-Amari**

urryera, sipas gjykimit më të saktë, bazuar në rregullin: “Lënia e veprës së pëlqyer nuk do të thotë se ky veprim është i urryer”. Mirëpo i mençuri që kërkon shpëtim nuk i humbet sevapet. I suksesshëm është ai të cilit Allahu i jep sukses për shfrytëzimin e kohëve të vyera përmes punë të mira e të dobishme.

★ ★ ★

# Kapitulli i dytë

*Dispozitat e dhikrit të ishrakut (agimit)*

### **Në këtë kapitull trajtohen 9 çështje**

#### **1. Emërtimi “namazi i ishrakut”, pse?**

Është emërtim etimologjik e metaforik i cili i referohet kohës kur kryhet ky namaz. Në hadithin e Ibën Abasit është transmetuar se ai falet pas lindjes së diellit.<sup>28</sup>

Kështu që nuk ka problem për këtë lloj emërtimi, ashtu siç është p.sh.namazit i teravive. Ky term është përdorur gjerësisht, edhe pse nuk ka argument për të.

#### **2. Gjykimi për dhikrin pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit**

Dijetarët (Allahu i mëshiroftë) kanë rënë në konsensus që dhikri pas sabahut është synet, madje thuhet se me këtë mendim janë pajtuar gjithë dijetarët. Kjo duket qartë në hadithet dhe në opinionet e dijetarëve që u përmendën më lart dhe në ato që do të vijnë më pas.

Argument për këtë është hadithi i transmetuar nga Simak bnu Harbin në “*Sahihun e Muslimit*”, i cili kur e pyeti Xhabir bnu Semeren për adhurimin që bënte Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) pas namazit të sabahut, ai (Xhabiri) u përgjigj: *“Ne ishim gjithmonë bashkë me Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Ai nuk ngrihej nga vendi në të cilin falte namazin e sabahut derisa lindi dielli. Pas lindjes së diellit ai çohet. Ata (sahabët) bisedonin, flisnin për kohën e Injorancës (paraislame) dhe qeshnin, ndërsa i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) buzëqeshte.”*

Në një transmetim tjetër citohet: *“Pas namazit të sabahut ai*

---

28) “El-Muxhemu el-kebiru” nga Taberaniu nr.967.

Një mësim i dobishëm: Hadithet në të cilat përmendet emërtimi “namazi i ishrakut” kanë ardhur të gjitha në rrugë të dobëta transmetimi. Ibën Haxheri ka saktësuar vetëm transmetimin e Ibën Abasit në librin e tij “El-Keshaf”.

*(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ulej në vendfaljen e tij derisa lindte dielli dhe dukej qartë.*"<sup>29</sup>

Dehleui El-Hanefi ka thënë: "Qëndrimi ulur në vendin e faljes deri në namazin e ishrakut (agimit) është synet (vepër e pëlqyer)."

Kadi Ijadi ka thënë: "Këtë synet e vepronin paraardhësit tanë të mirë dhe dijetarët. Kohën pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit e veçonin për të përmendur Allahun dhe për t'iu lutur Atij."

Desuk El-Maliki, pasi përmend hadithin që flet për vlerën e dhikrit në agim dhe namazin në këtë kohë, thotë: "I mençuri nuk duhet ta humbasë këtë mirësi të madhe."

Ibën Alishi thotë: "Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka përmendur se kush bën dhikër pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit dhe pastaj fal dy rekate, do të marrë shpërblimin e haxhit dhe të umres të plotë, të plotë, të plotë." Fjalën "të plotë" e ka përsëritur tre herë, duke theksuar rëndësinë e kësaj vepre dhe për të nxitur njerëzit që ta kryejnë atë. Prandaj, i mençuri nuk duhet ta privojë veten nga kjo mirësi e madhe."

Ibën Haxhi El-Maliki thotë: "A nuk sheh çfarë është transmetuar për dhikrin dhe lutjet që bënin ata pas namazit të sabahut dhe të ikindisë?! Në këto dy kohë ata ishin në xhami dhe dukej sikur prisnin namazin e xhumasë. Në xhami dëgjohej zëri i tyre si gumëzhitja e bletës."

Imam Neuiu thotë: "Dije se koha më e mirë e dhikrit gjatë ditës është pas namazit të sabahut."

Ibën Kudame ka thënë: "Është e pëlqyer që pas namazit të sabahut të qëndrohet në vendin e faljes deri në lindjen e diellit."

A nuk ka ardhur koha për të reflektuar që të bashkëpunojmë për ringjalljen e këtij syneti në shtëpitë e Allahut; të këshillojmë njerëjtjetrin dhe të garojmë në kryerjen e kësaj vepre të mirë?

---

29) Transmeton Muslimi nr.286 dhe 287.

### **3. Vlera e qëndrimit ulur në vendin e faljes pas namazit të sabahut me qëllim përmendjen e Allahut**

Janë transmetuar hadithe të ndryshme për vlerën e këtij syneti:

1. Atau bnu Saibi shkoi në xhaminë ku falej Ebu Abdurrahman Es-Selami pas namazit të sabahut dhe e gjeti atë ulur. Ebu Abdurrahman Es-Selami i tha se kam dëgjuar Aliun (Allahu qoftë i kënaqur me të) i cili kishte dëgjuar Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) që tha: *“Ai që fal namazin e sabahut dhe pastaj qëndron në vendin ku falet duke bërë dhikër, për të luten engjëjt: “O Zot, fale! O Zot, mëshiroje!” Edhe për atëqë është duke pritë namazin engjëjt luten: “O Zot, fale! O Zot, mëshiroje!”*<sup>30</sup>

2. Ebu Umame (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Që të qëndroj pas namazit të sabahut për të përmendur Allahun, ta madhëroj Allahun me tekbir (Allahu ekber), ta falenderoj me tehmîd (Elhamdulillah) dhe ta përmend me tehlîl (La ilahe ila Allah) derisa të lindë dielli, kjo është më e dashur për mua sesa të liroj dy sklevër prej bijëve të Ismailit (arabë); dhe (dhikri) pas namazit të ikindisë derisa të perëndojë dielli (është më e dashur për mua) sesa të liroj katër sklevër prej bijve të Ismailit.”*<sup>31</sup>

3. Ebu Hurejra transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Engjëjt luten: “O Zot, fale! O Zot, mëshiroje!” për ndonjërin prej jush për sa kohë që ai qëndron në vendin ku ka falur namazin dhe nuk e ka prishur abdesin.”*<sup>32</sup>

---

30) Transmeton Imam Ahmedi dhe Bezari. Ibën Haxheri e ka saktësuar këtë hadith në librin “Muhteseru El-Bezari” 412/2, ndërsa Imam Albani e ka konsideruar të dobët në librin “Daifu et-tergibi” 239 .

31) El-Musned nr. 22194; Imam Albani e ka saktësuar këtë hadith në librin “Sahih et-tergib ue terhib” nr. 446.

32) Buhariu 445, Muslimi 274.

#### 4. Fillimi dhe fundi i kohës së qëndrimit në vendin e faljes për të përmendur Allahun

Fillimi i kohës është pas namazit të sabahut dhe vazhdon deri pas lindjes së diellit. Argument për këtë është hadithi i transmetuar nga Muslimi që thotë: *“I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) pasi falte namazin (e sabahut) qëndronte ulur në vendin ku falej derisa lindte dielli dhe dukej qartë.”*

Prandaj, besimtari që kërkon të zbatojë këtë synet nuk duhet të dalë nga xhamia vetëm se pas lindjes së diellit, duke ndjekur e pasuar kështu Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

Transmetohet nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të) se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Vërtet, kjo fe është e lehtë. Kush e shtrëngon këtë fe, ajo do ta mposhtë. Ndiqni të drejtën (në fjalët dhe në veprat tuaja në çdo aspekt dhe nëse nuk mundeni të arrini më të mirën atëhere) dhe afrojuni asaj (bëni aq sa të mundeni). Përgëzoni dhe lehtësoni! Shfrytëzoni agimin, mbrëmjen dhe diçka nga nata.”*<sup>33</sup>

Kastalani ka thënë: *“Në mënyrë metaforike: mëngjesi, mbrëmja dhe një pjesë e vogël e natës janë kohët e aktivitetit dhe përkushtimit të zemrës ndaj adhurimeve. Këto janë tre kohët më të mira për udhëtarin. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) sikur e mëson udhëtarin si të arrijë qëllimin e tij; i tërheq vëmendjen që të bëjë kujdes duke i shfrytëzuar këto tre kohë, kur është aktiv. Udhëtari që vazhdon të udhëtojë ditë e natë, pa ndërpreje, do të lodhet dhe do ta ndërpresë udhëtimin. Kur zgjedh të udhëtojë në këto kohë që është aktiv, do ta vazhdojë udhëtimin deri në fund pa vështirësi. Ka përdorur një metaforë të bukur për të treguar se kjo botë realisht është një urë kalimi për në botë tjetër dhe se këto janë kohët më të këndshme për njeriun që do t'i përkushtohet adhurimit.”*

Ibën Rexhepi ka thënë: *“Këto janë tre kohët e punës e të udhëtimit drejt*

---

33) Buhariu 5043.

*Allahut.”*

Mela Ali El-Hanefi ka thënë: “Mëngjesi dhe mbrëmja janë dy kohë kur njerëzit anojnë nga rehatia dhe tregohen të shkujdesur.”

### **5. Nëse njeriu e ndërpret dhikrin dhe largohet nga xhamia para lindjes së diellit, a shpërblehet për kohën e qëndrimit në xhami?**

Kjo çështje është identike me atë të ndërprerjes së tauafit pa i plotësuar shtatë rrotullime dhe si ai që e ndërpret namazin e agjërimin vullnetar. Këto çështje janë subjekt mosmarrëveshjes mes dijetarëve (Allahu i mëshiroftë).

Është thënë që merr shpërblimin nëse e ndërpret me arsye, ndërsa kur e ndërpret pa arsye, nuk shpërblehet. Gjithashtu është thënë se shpërblehet vetëm për kohën e qëndrimit. Gjithsesi, të dyja mendimet janë për t'u marrë në konsideratë.

### **6. Gruas në xhami, të sëmurit në spital, rojeve dhe atyre që kanë detyra në vende të caktuara, gjithë këtyre: a u lejohet që të bëjnë dhikër në vendin ku falin namazin apo është kusht që kjo të ndodhë në xhami?**

Nga argumentet e lartpërmendura duket qartë se nuk është kusht që dhikri pas sabahut të bëhet vetëm në xhami. Kështu që gruaja dhe të tjerë si ajo mund të ulen e ta përmendin Allahun deri në lindjen e diellit në vendin ku e kanë falur namazin e sabahut.

Argumentet e mëposhtme e mbështesin këtë mendim:

1. Muxhahidi tregon se Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) gjatë Ramazanit pas namazit të sabahut lexonte Kuran derisa lindte dielli. Pastaj flinte.<sup>34</sup>

2. Gjithashtu Muxhahidi tregon se Aishja (Allahu qoftë i

---

34) “Musaneef bnu Ebi Shejbe” 25451, “Fedail El-Kurani” nga Ferijabi nr.137.

kënaqur me të) në Ramazan pas namazit të sabahut qëndronte ulur duke përmendur Allahun. Kur afrohej koha e lindjes së diellit urdhëronte dikë që të shihte horizontin për t'u siguruar për lindjen e diellit.<sup>35</sup>

3. Në “*Sahihun e Muslimit*” transmetohet se Xhevrja (Zoti qoftë i kënaqur me të) ka thënë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) një ditë doli prej saj herët për të falur namazin e sabahut, ndërsa ajo qëndronte ulur në vendfaljen e saj duke përmendur Allahun. Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) u kthye tek ajo paradite dhe i tha: “*Vazhdon në gjendjen që të lashë?*” Ajo tha: “Po.” I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i tha: “*Kur u largova prej teje thashë tre herë katër fjalë, të cilat nëse do të peshoheshin do të ishin në të njëjtën masë me dhikrin që ke bërë ti nga sabahu deri tani. Ato katër fjalë janë: Subhan Allahu ue bi hamdihi, adede halkihi, ue rida nefsihi ue zinete arshihi, ue midade kelimatih (Pa tëmetaështë Allahu dhe i bëj hamd (e lavdëroj) Atij: aq sa numri i krijesave të Tij, aq sa pëlqen Ai, aq sa peshon Arshi i Tij, sa numri i shumtë dhe i pafundmë i fjalëve të Tij).*”<sup>36</sup>

Ibën Abdulberri (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: “*Sikur gruaja në vendfaljen e vet në shtëpi të presë hyrjen e kohës së namazit dhe pastaj të çohet të falet, nuk është çudi që të përfshihet në kuptimin e hadithit (të përfitojë shpërblimin e përmendur në hadith), sepse ajo e mban veten dhe nuk largohet nga vendfalja për shkak të dëshirës për t'u falur dhe nga droja se mos preokupohet me diçka tjetër dhe i humbet namazi.*”

**7. A është kusht dhikri, kur qëndron ulur në vendin e faljes pas namazit të sabahut, për të fituar shpërblimin e përmendur në hadith dhe për zbatimin e këtij syneti?**

35) “Fedail El-Kurani” nga Ferijabi nr.138.

36) Muslimi 79.

Po, argumentet dukshëm e pohojnë këtë.

### **8. Gjykimi për fjalët dhe bisedat gjatë kësaj kohe**

Fjalët dhe bisedat gjatë kësaj kohe janë të papëlqyera. Kështu mendon një pjesë e dijetarëve. Moskryerja e veprave të mira e të pëlqyera është e qortueshme. Ky është arsyetimi i atyre që e mbështesin këtë mendim. Transmetohet se Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë:

*“I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) nuk çohet nga vendi ku falte namazin e sabahut derisa lindte dielli. Pas lindjes së diellit ai çohet. Gjatë kësaj kohe nuk fliste me njerëzit. Ata bisedonin, kujtonin kohën e Injorancës (paraislamit) dhe qeshnin, ndërsa Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) buzëqeshte.”*<sup>37</sup>

Dhe në një transmetim: *“Kur lindte dielli çohet. Ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) heshte gjatë.”*<sup>38</sup>

Hasen bnu Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me tëdy) ka thënë: *“Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) nuk fliste derisa lindte dielli.”*

Imam Maliku ka transmetuar se Seid bnu Ebi Hindi, Nafiu dhe Musa bnu Mejsere qëndronin ulur duke përmendur Allahun pas namazit të sabahut derisa zbardhte agimi. Pastaj ndaheshin. Pas kësaj kohe ata nuk flisnin me njëri-tjetrin. E pyetën: *“A ishin të zënë me përmendjen e Allahut?”*

Ai tha: *“Po.”*<sup>39</sup>

Esma bintu Uatheletu ka thënë: *“Babai im pasi falte namazin e sabahut ulëj në drejtim të Kiblës dhe nuk fliste derisa lindte dielli. Ndodhte që i flisja për ndonjë nevojë, ndërsa ai nuk më kthente përgjigje.”*<sup>40</sup>

---

37) Ahmedi në librin “Musned” nr. 20844.

38) Transmeton Tabarani në librin “El-Muxhemu el-kebiru” nr.1933.

39) “Tarihu Dimeshk” nga Ibën Asakiri 435/61.

40) “Tarihu Dimeshk” 96/31.

Mejmuni ka thënë: *“Kam arritur njerëz që nuk flisin vetëm se të vërtetën ose heshtnin. Kam parë nga ata që nuk flisin pas namazit të sabahut derisa lindte dielli, vetëm se kur ishte e nevojshme dhe për gjëra të dobishme.”*<sup>41</sup>

Imam Maliku pasi i falte dy rekatet para namazit të sabahut fliste për çështje të dijes. Pas përfundimit të namazit të sabahut nuk fliste me asnjë derisa lindte dielli.

Zejnudin El-Iraki pas namazit të sabahut, përgjithësisht, vazhdonte të rrinte ulur në vendin ku ishte falur, i drejtuar nga Kibla, duke lexuar Kuran dhe duke e përmendur Allahun derisa lindte dielli.

Imam Gazaliu ka thënë: *“Në vija të përgjithshme, besimtari në ditën e xhuma i shton lutjet dhe veprat e mira. Kur Allahu e do robin, ia mundëson atij që t’i përdorë kohët e vyera duke bërë vepra të mira. Ndërsa kur e urren ia mundëson atij që t’i përdorë kohët e vyera duke bërë vepra të liga, për të qenë më i dhimbshëm ndëshkimi i tij dhe si arsye më e fortë për t’u urreyer. Ai e meriton urrejtjen për shkak se e privon veten nga bereqeti i kësaj kohe dhe i shkel shenjtëritë e saj përmes gjynaheve.”*

E lusim Allahun që të mos na privojë nga mirësitë e kohëve dhe sezoneve të begata; kërkojmë strehim tek Allahu prej privimit nga mirësitë dhe nga braktisja.

Ibën Kajimi thotë: *“Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) pasi e kryente namazin e sabahut, i përkushtohej tërësisht përmëndjes së Allahut dhe bënte dhikrin e ligjëruar të mëngjesit. Këtë e bënte çdo ditë, në mënyrë sistematike, pa lënë mangut asgjë. Përveç kësaj, shtonte çfarë dëshironte edhe pjesë të tjera të dhikrit apo lexonte Kuran derisa lindte dielli. Pasi lindte dielli falte dy ose më shumë rekatet të namazit të duhasë (paradites). Pastaj dilte nga xhamia me përulësi ndaj Zotit duke iu lutur Atij dhe duke kërkuar prej Tij që ta ndihmonte edhe në pjesën tjetër të ditës për të bërë vepra të mira që e kënaqin Atë. Prandaj, ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) nuk bënte vetëm se atë çfarë e shihte*

41) “Safuetu Es-Safuetu” nga Ibën El-Xheuzi 361/2.

*qartazi se e kënaqte Zotin e tij. Veprat e zakonshme e të natyrshme ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), me nijetin e tij, i shndërronte në adhurime. Përmes tyre synonte të fitonte kënaqësinë e Allahut.”*

**Mendimi më afër së vërtetës** është se lejohen fjalët dhe bisedat gjatë kohës kur njeriu qëndron ulur për të përmendur Allahun pas sabahut derisa të lindë dielli. Argument për këtë është hadithi i Xhabirit i lartpërmendur. I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) nuk i qortoi sahabët për bisedat që bënin. Gjithashtu mund të thuhet se fjalët e tyre nuk ishin të zhveshura nga dobitë fetare. Sikurse duhet theksuar se nuk është mirë që të kalohet e gjithë koha me biseda. Fjalët dhe bisedat në këtë kohë nuk janë të urryera, sepse el-kerahatu (e papëlqyera, e kritikuara) është një prej gjykimeve të shariatit që ka nevojë për argument. Mirëpo, s'ka dyshim që fjalët e bisedat janë humbje kohe dhe shpërblimi.

### **9. Qëndrimi në vendin e faljes për të marrë dije përmes mësimave apo përmes studimit individual pas sabahut deri në lindjen e diellit, a e ndërpret shpërblimin e përmendur në hadith?**

**Përgjigjja:** Transmetohet nga Enes bnu Malik (Allahu qoftë i kënaqur me të) se Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Të ulem me njerëz që e përmendin Allahun nga namazi i sabahut deri në lindjen e diellit, kjo është më e dashur për mua sesa të liroj 4 skllevër nga bijtë e Ismailit (arabë). Të ulem me njerëz që e përmendin Allahun nga namaz i ikindisë deri në perëndimin e diellit, kjo është më e dashur për mua sesa të liroj 4 skllevër.”*<sup>42</sup>

Disa komentues të hadithit kanë thënë: *“Fjala e tij “Të ulem me njerëz që e përmendin Allahun” ka për qëllim ata që e përmendin Allahun dhe marrin dijen, por ndoshta ka për qëllim vetëm ata që e përmendin Allahun. Ekzistojnë të dyja mundësitë. Gjithsesi, nuk ka për qëllim ata që*

---

42) Transmeton Ebu Daudi nr.3667; Imam Albani e ka saktësuar këtë hadith në librin e tij “Sahihu El-Xhamiu” nr.5036.

*e bëjnë dhikrin me xhemat- të gjithë së bashku në të njëjtën kohë- këtë të fundit e ka sqaruar Ibën Haxhi El-Maliki (Allahu e mëshiroftë).”*

Kush mediton rreth gjendjes së paraardhësve tanë të mirë dhe për fjalët e veprat e tyre, siç u përmend më parë, do të konstatojë se ata e shfrytëzonin këtë kohë për të bërë dhikër dhe për t’u lutur; nuk tuboheshin për kërkimin e dijes.

Nga çfarë u tha më lart, duket qartë se paraardhësit tanë të devotshëm besonin që përkushtimi ndaj dhikrit pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit është më i mirë se përkushtimi ndaj diturisë dhe mësimi të njerëzve.

Euzaiu ka thënë: *“Paraardhësit tanë të mirë i shihje në agim, ose pak para tij, në një gjendje të tillë: sikur zogjtë qëndronin mbi kokat e tyre; ishin tërësisht të angazhuar me veten e tyre, saqë, sikur për disa çaste ndonjërit prej tyre t’i largohej njeriu i dashur i zemrës dhe të kthehej sërish, ai nuk do ta hetonte këtë gjë. Në këtë gjendje ishin ata deri para lindjes së diellit; pastaj çoheshin, takonin njëri-tjetrin dhe tuboheshin në kërkim të diturisë. Gjëja e parë që i preokuponte ishte bota tjetër dhe rrugetimi drejt saj. Pastajmësonin fik’hun (e drejta islame) dhe Kuran.”*<sup>43</sup>

*Çështja e namazit të ishrakut (agimit) do të trajtohet në kapitullin e tretë - inshallah (në dashtë Allahu).*

---

43) “Tarihu Dimeshk” nga Ibën Asakiri 184/35.



## **Kapitulli i tretë**

*Dispozitat për namazin e ishrakut*  
(namazit të agimit që falet pas lindjes së diellit)

### **Ky kapitull trajton 31 çështje**

#### **1. Namazi i ishrakut (namazit të agimit që falet pas lindjes së diellit)**

Janë dy rekate që falen pasi lind dielli dhe kalon ajo pjesë e kohës gjatë se cilës namazi nuk është i pëlqyer. Ky emërtim i referohet kohës – sikurse u përmend dhe në vijim do të japim më shumë sqarime – in shaa Allah (në dashtë Allahu).

#### **2. Dy rekatet e namazit të ishrakut, a janë ato të namazit të duhasë (paradites) apo është namaz më vete?**

Kjo çështje është subjekt i mosmarrëveshjes mes dijetarëve (Allahu i mëshiroftë):

**Mendimi i parë:** Dy rekatet e namazit të ishrakut janë dy rekatet e duhasë. Nuk ka ndonjë namaz që quhet “namazi i ishrakut”. Ky është mendimi i Ibën Abasit dhe një pjese të dijetarëve. Shumica e komentuesve të Kuranit janë të këtij mendimi.

Argumentet e tyre:

1. Nuk është transmetuar ndonjë argument i saktë për këtë çështje. Gjithçka që ka ardhur është e dobët.

2. Muslimi transmeton nga Semak bnu Harbi se ka thënë: “E pyeta Xhabir bnu Semren: “A uleshe me Profetin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)?” Ai tha: “Po, shumë. Ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) nuk çohet nga vendi ku falte namazin e sabahut derisa lindte dielli. Kur lindte dielli, çohet. Ata (sahabët) bisedonin me njëri-tjetrin, flisnin për kohën e Injorancës (paraislame) dhe qeshnin, ndërsa Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) buzëqeshte.” Në një transmetim tjetër citohet: “Pasi falte namazin e sabahut, qëndronte ulur në vendin ku ishte falur derisa lindte dielli dhe dukej qartë.”

I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) qëndronte ulur derisa lindte dielli. Pastaj çohet. Nuk

është transmetuar që ai falej. Kështu vepronin edhe sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta).

3. Nuk ka ardhur diçka në tekstet e sheriatit që të flasë qartë për namazin e ishtrakut (agimit).

4. Kanë ardhur hadithe që tregojnë se namazi i ishtrakut është namazi i duhasë (paradites). Prej këtyre haditheve përmendim: *“Kush qëndron ulur në vendin ku fal namazin e sabahut, duke e përmendur Allahun, derisa të falë namazin e duhasë dhe nuk flet vetëm se fjalë të mira, këtij do t’i falen gjynahet, edhe nëse ato janë më shumë se shkuma e detit.”*<sup>44</sup>

Në hadith është përmendur *“namazin e duhasë”*. Ky hadith është sqarim i haditheve të tjera.

5. Ebu Umame dhe Utbetu bnu Abduselami transmetojnë se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Kush e fal namazin e sabahut me xhemat, pastaj qëndron në vendin ku është falur derisa të falë namazin e duhasë, ai merr shpërblimin e plotë të haxhit dhe të umrës.”*<sup>45</sup>

6. Ibën Umeri transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Kush e fal namazin e sabahut, pastaj qëndron ulur ku është falur duke përmendur Allahun derisa lind dielli, pastaj fal dy rekatet e duhasë, namazi i tij është njësoj si haxhi dhe umreja të pranuar.”*<sup>46</sup>

Argumenti është i qartë: dy rekatet i konsideroi prej duhasë. Kështu që namazi i përmendur në hadith është namazi i duhasë.

7. Amra transmeton nga Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)

---

44) Transmeton Ebu Daudi në librin “Es-Sunen” nr.1287; Imam Albani e konsideron hadith të dobët, ndërsa Ibnu Haxheri në librin “Tahrixh Mishkatu El-Mesabihu” 74/2 e konsideron hadith hasen (të mirë)

45) “Tarihu Dimeshk” nga Ibën Asakiri 352/7; “Mexhmu ez-zeuid” nga Hejthemi 104/10.

46) Transmeton Tabaraniu në librin “El-Muxhemu el-eusetu” nr.5602; Ibën Haxheri e konsideron hadith hasen (të mirë) në librin e tij “Netaixhu el-efkëri” dhe Ibën Bazi në “Mexhmua el-fetaua” 378/12.

ka thënë: *“Kush e fal namazin e sabahut, qëndron ulur në vendin e faljes, nuk flet për gjëra të padobishme të kësaj bote dhe e përmend Allahun derisa e fal namazin e duhasë në katër rekate, ky kthehet në pafajësi si në ditën që e ka lindur nëna e vet.”*<sup>47</sup>

8. Hadithet e transmetuara për namazin e ishrakut janë të dobëta dhe për faktin se aludohet se është caktuar një shpërblim shumë i madh për një punë kaq të lehtë. Kjo konfirmon pasaktësinë e hadithit të Enesit (Zoti qoftë i kënaqur me të): *“Kush e fal namazin e sabahut me xhemat, pastaj qëndron ulur për të përmendur Allahun derisa të lindë dielli dhe pastaj fal dy rekate, ky shpërblehet njësoj si për një haxh dhe umre të plotë, të plotë, të plotë.”*

9. Muxhahidi transmeton se kur lindte dielli Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) shtrihej të flinte gjumë në pjesën e parë të ditës (duhasë -paradites).<sup>48</sup>

Në këtë transmetim nuk përmendet namazi pas dhikrit të sabahut, sikur të mos e dinte këtë gjë, ndërkohë që ajo ishte bashkëshorte e Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Si mund të ishte e panjohur për të kjo çështje?!

**Mendimi i dytë:** Namazi i ishrakut (agimit) është namaz më vete. Ky është mendimi i një pjese të juristëve islam.

Argumentet e transmetuara, në të cilat përmendet namazi i ishrakut (agimit), janë të qarta.

Prej këtyre argumenteve përmendim:

1. Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Kush e fal namazin e sabahut, pastaj qëndron ulur duke përmendur Allahun derisa të lindë dielli dhe pastaj fal dy rekate, shpërblehet*

---

47) Transmeton Ebu Jala në “Musnedin” e tij nr.4365.

48) “Musanef” Ibën Ebi Shejbe nr. 25451, zinxhiri i transmetimit të tij është i saktë.

*njësoj si të ketë kryer haxhin dhe umren të plotë, të plotë, të plotë.”<sup>49</sup>*

2. Ebu Umame transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Kush e fal namazin e sabahut me xhemat, pastaj ulet për të përmendur Allahun derisa të lindë dielli, pastaj çohet dhe fal dy rekate, shpërblehet sikur të ketë kryer haxhin dhe umren.”<sup>50</sup>*

3. Ebu Hurejra transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dërgoi një ekspeditë ushtarake, e cila kishte fituar shumë plaçkë lufte përmes një sulmi të shpejtë. Një burrë i tha: *“O i Dërguari i Allahut, nuk kemi parë ekspeditë më të shpejtë se kjo; asnjë ekspeditë tjetër nuk ka fituar më shumë plaçkë lufte se kjo.”* I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) tha: *“A t’ju tregoj diçka që është më e shpejtë në sulm se ekspedita dhe më dobiprurëse se ajo? Një njeri që merr abdes në shtëpinë e tij, në formën më të mirë, pastaj shkon në xhami në të cilën fal namazin e ishrakut (agimit), pastaj e pason atë me dy rekatet e duhasë (paradites), kjo është më e shpejtë sesa sulmi i ekspeditës dhe më dobiprurëse se ajo.”<sup>51</sup>*

4. Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i falte dy rekate kur dilte dielli dhe ngrihej në horizont sa një apo dy shtiza. Pastaj qëndronte derisa hynte koha e duhasë (paradites) dhe falte 4 rekate.<sup>52</sup>

49) Transmeton Tirmidhiu në “Sunen” nr.586; Sheukani, Albani, Ibën Bazi dhe Ibën Utnejmni thonë se është hadith hasen (i mirë).

50) Transmeton Tabarani në librin “El-Kebiru” nr.7741; Mundhiri thotë se ky është hadith hasen (i mirë) në librin “Et-tergubu ue terhubu” nr.672.

51) Transmeton Ibën Hibani nr.2535; Arnauti e konsideron hadith të saktë, ndërsa Albani thotë që është hadith hasen.

52) Transmeton Nesaiu në librin “Es-Sunen” nr.473; Albani e konsideron hadith hasen (të mirë) në librin “Es-Silsiletu es-sahihatu” nr.237.

5. Ebu Umame transmeton se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Fale namazin e sabahut; pastaj ndërprite namazin derisa dielli të ngrihet në horizont sa një shtizë, sepse ai del ndërmjet dy brirëve të shejtanit dhe në këtë kohë jobesimtarët i bëjnë sexhde (i gjunjëzohen) atij. Pas kësaj kohe falu, sepse namazi yt do të jetë i dëshmuar (nga engjëjt). Lejohet të falesh derisa hija e një shtize të bëhet më e vogël se gjatësia e saj. Pas kësaj ndërprite namazin, sepse në këtë kohë (në mesditë) Xhehenemi ushqehet me lëndën e tij djegëse (nxehhtësia e tij arrin kulmin). Kur vjen hija (dielli anon nga zeniti - kalimi i diellit nga kupola qiellore), ti mund të falesh, se namazi yt do të jetë i dëshmuar (nga engjëjt) derisa të falësh ikindinë. Pas kësaj kohe, mos u fal derisa të perëndojë dielli, sepse ai perëndon midis dy brirëve të shejtanit dhe kjo është koha kur jobesimtarët i bëjnë sexhde atij.”*<sup>53</sup>

Disa komentues të hadithit sqarojnë se me fjalët e tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): *“Pas kësaj kohe falu, sepse namazi yt do të jetë i dëshmuar (nga engjëjt)”*, ka për qëllim namazin e ishrakut (agimit) ose namazin e duhasë (paradites).

6. Musa bnu Talha tregon për babain e tij, Talhën, se ai qëndronte në vendin ku kishte falur namazin e sabahut dhe pastaj vazhdonte të bënte dhikër.<sup>54</sup>

Kështu ka vepruar sahabiu i nderuar Talha bnu Ubejdullah, njëri prej 10 të përgëzuarve me Xhenet.

7. Hasan bnu Aliu tregon se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Kush e fal namazin e sabahut, dhe qëndron ulur (duke bërë dhikër) derisa lind dielli dhe pastaj i fal dy rekate, Allahu do t’ia ndalojë Zjarrin që ta djegë atë apo që të ushqehet me të (që të jetë lëndë djegëse e Zjarrit).”*<sup>55</sup>

---

53) Muslimi nr. 294.

54) Transmeton Ibën ebi Shejbe në “Musaneff” nr.7767.

55) Transmeton Bejhakui në librin “Shuab el-imani” nr.2697.

**Përfundimi:** Pas këtij studimi të çështjes arrijmë në konkluzionin:<sup>56</sup>

1. Mendimi që namazi i ishrakut (agimit) është synet më vete i referohet një pjese të konsiderueshme prej dijetarëve të mëdhenj, të hershëm e të mëvonshëm, juristë islam dhe ekspertë të hadithit.

2. Duhet marrë në konsideratë mendimi që pohon se ka vlera të mëdha qëndrimi ulur pas namazit të sabahut, me qëllim përmendjen e Allahut deri në agim. Ky mendim i referohet një pjese të konsiderueshme prej ekspertëve të hadithit, sikurse u përmend.

3. Opinionet që mbështeten nga argumentet nuk mund të anashkalohen.

4. Sa i përket dhikrit pas namazit të sabahut deri në agim, ka situata të ndryshme, prandaj për çdo situatë është caktuar shpërblim i veçantë.

5. Dhikri pas sabahut deri në agim dhe namazi i agimit kanë vlera të mëdha.

6. Namazi i ishrakut (agimit) është namazi i duhasë (paradites) në kohën e tij të parë, për arsyet e mëposhtme:

a. Adhurimet kanë natyrë *teukifije* (ato nuk lejohen vetëm nëse ka argumente nga Kurani dhe Suneti).

b. Sikur namazi i ishrakut të ishte namaz më vete, do të na ishte transmetuar nëpërmjet haditheve të sakta dhe të qarta nga sahabët. Këtë çështje të rëndësishme ata nuk do ta neglizhonin.

c. Argumentet që flasin për namazin e ishrakut i referohen namazit të duhasë. Ato janë të natyrës interpretuese që sqarojnë argumentet e përgjithshme.

d. Prej argumenteve që pohojnë se namazi i ishrakut është namazi i duhasë është dhe fjala e Profetit (paqja dhe bekimet e

---

56) Diskutimin e argumenteve për secilin nga dy mendimet lexoje në librin original.

Allahut qofshin mbi të): “Zoti juaj i Lartësuar ka thënë: “O biri i Ademit, falu për Mua në pjesën e parë të ditës, që Unë të të mjaftoj në pjesën tjetër të saj.”<sup>57</sup>

e. Në një transmetim citohet: “Fali pa përtesë katër rekate.”<sup>58</sup> Ky hadith është marrë si argument për namazin e duhasë, sepse pjesa e parë e ditës është ajo pas lindjes së diellit. Të këtij mendimi janë shumë ekspertë të hadithit.

f. Hadithet që flasin për vlerën e namazit të ishrakut (agimit) – edhe pse janë të dobëta – mund të merren në konsideratë dhe të punohet me to në kontekstin “e vlerave të veprave të mira”, e sidomos për faktin që ka shumë transmetime dhe ato kanë ardhur në rrugë të ndryshme. Gjithashtu duhet theksuar se ato nuk janë hadithe shumë të dobëta dhe se shumica e dijetarëve e kanë lejuar transmetimin e tyre.

### **3. Përmbledhje e vlerave e mirësive të dhikrit pas namazit të sabahut dhe namazit të ishrakut (agimit) e përfituar nga hadithet që flasin për këtë çështje**

Kush studion hadithet e transmetuara për përmendjen e Allahut pas namazit të sabahut konstaton gjendje të ndryshme:

1. Qëndrimi ulur në vendin ku falet namazi i sabahut, pa u përmendur qartë shpërblimi apo dhikri.

2. Qëndrimi ulur duke përmendur qartë vetëm shpërblimin që fitohet dhe jo dhikrin.

3. Qëndrimi ulur pas sabahut, me qëllim përmendjen e Allahut, duke treguar gjithashtu dhe shpërblimin që fitohet nga kjo vepër.

4. Qëndrimi ulur pas sabahut me qëllim përmendjen e Allahut deri në lindjen e diellit dhe faljen e namazit të ishrakut (agimit), pa përmendur përfitimin nga kjo vepër.

---

57) Transmeton Tirmidhi nr.475.

58) Transmeton Ahmedi nr. 22469; Imam Neueuiu, Sheukani, Hejthemi dhe Albani e konsiderojnë hadith të saktë.

5. Qëndrimi ulur për të bërë dhikër dhe përmendja e vlerës së tij. Gjithashtu cilësimi i namazit që falet në këtë kohë, i cili është namazi i duhasë (paradites) dhe përfitimi që vjen prej tij.

6. Qëndrimi pas sabahut në vendin e faljes për të bërë dhikër dhe për të falur namazin pa e cilësuar cili namaz është ky dhe përfitimi që vjen prej tij.

Për të bërë pajtimin e gjithë këtyre transmetimeve vlerësojmë që:

1. Vlerat e mirësitë e veprave janë të ndryshme, por edhe shpërblimi gjithashtu. Çdo shpërblim vlen për veprën e përmendur në tekst.

2. Janë në kontekstin e haditheve të përgjithshme, të cilat janë sqaruar nga hadithe të tjera.

#### 4. Numri i rekateve të namazit të ishrakut (agimit)

Namazi i ishrakut ka vetëm dy rekate, sipas atyre që mendojnë se është namaz më vete (s'ka lidhje me namazin e duhasë – paradites), gjë që duket qartë në tekst. Nëse falen më shumë se dy rekate, kjo, përgjithësisht, bën pjesë në namazin nafile (vullnetar).

#### 5. Koha e tij

Koha e namazit të ishrakut (agimit) është pas lindjes së diellit dhe ngritjes së tij në horizont sa një shtizë. Dijetarët e kohës sonë ndajnë mendime të ndryshme në lidhje me përlllogaritjen e kësaj kohe:

**Mendimi i parë:** Llogaritet që të jetë 10-12 minuta pas lindjes së diellit.

**Mendimi i dytë:** 10 minuta.

**Mendimi i tretë:** Koha gjatë së cilës ndalohet falja e namazit pas lindjes së diellit është 12-15 minuta, bazuar në ngritjen e diellit 4 gradë. Një gradë llogaritet afërsisht 4 minuta. Kjo kohëzgjatje nuk është konstante. Ajo ndryshon në varësi të stinëve. Nuk është njësoj në verë e në dimër. Por, kohëzgjatja maksimale në Mbretërnë e Arabisë Saudite është 15 minuta. Sa më në veri të jetë vendi ku

bëhen matjet, aq më shumë rriten minutat. Kështu mendojnë një pjesë e astronomëve.

**Për të qenë të sigurt themi** se kjo kohë (koha e ndalesës së namazit pas lindjes së diellit) zgjat 15 minuta, duke iu larguar njëkohësisht edhe mosmarrëveshjeve. Gjithashtu vlen të theksohet se duhet marrë në konsideratë fjala e ekspertëve, e sidomos për faktin se ata e mbështesin gjykimin e tyre mbi studime shkencore të përpikëta.

Në hadith përmendet se koha e namazit të ishrakut fillon kur dielli ngrihet në horizont një shtizë. Disa dijetarë përmes përllogaritjeve kanë nxjerrë se kjo është afërsisht një metër. Disa të tjerë thonë se shtizat janë të ndryshme: ca janë të gjata dhe ca të shkurtra. Gjithsesi dijetarët marrin në konsideratë gjatësinë mesatare.

### ► **Vini re!**

1. Disa njerëz gabojnë duke e falur namazin e ishrakut bazuar në kalendarin e kohëve të namazit, ku shkruhet “*koha e ishrakut*”. Kjo është gabim, sepse bëhet fjalë për kohën e lindjes së diellit, që, siç e dimë, në këtë kohë është i ndaluar namazi. Namazi duhet të falet pas kësaj kohe.

2. Siç u përmend, pas lindjes së diellit ndalohet namazi derisa ai të ngrihet sa një shtizë. Kjo kohë ndryshon nga një vend në tjetrin.

**6. A ka kohë të limituar namazi i ishrakut? E thënë ndryshe: A duhet të falet menjëherë sa hyn koha e tij apo ka hapësirë kohore?**

Kjo çështje është subjekt mosmarrëveshesh midis dijetarëve (Allahu i mëshiroftë).

Mendimi i parë: Koha është e gjërë, në analogji me namazin e duhasë (paradites).

Mendimi i dytë: Nëse namazin e fal menjëherë pas përfundimit të kohës së ndaluar, atëhere këto janë dy rekate të namazit të ishrakut; nëse kalon një kohë e gjatë, ky është namazi i duhasë. Kjo duket më e saktë dhe më e mirë, sepse në këtë kontekst kanë ardhur hadithet dhe nuk humbet shpërblimi.

## **7. A mund të futen te njëra - tjetra dy rekatet e ishrakut dhe dy rekatet e duhasë?**

U sqarua që mendimi më i saktë është se namazi i ishrakut është namazi i duhasë në kohën e parë të tij. Ndërsa sipas mendimit që ishraku ka namaz më vete, dijetarët thonë se ka ndërfitje mes dy namazeve, nëse bëhet nijeti për të dyja.

Mund të thuhet gjithashtu se nuk ka ndërfitje, sepse secili prej tyre është synet më vete, siç ndodh me synetet e forta para dhe pas namazeve të obliguara. Në origjinë, nuk ka ndërfitje ndërmjet adhurimeve, siç do ta sqarojmë më pas përmes fjalëve të dijetarëve, kur flasin për gjykimin mbi ndërfitjen ndërmjet syneteve.

## **8. Kushtet për fitimin e shpërblimit të caktuar për dhikrin pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit**

Melau el-Hanefiu ka cituar Ibën Haxher El-Askalanin të ketë thënë: *“Shpërblimi i premtuar fitohet atëhere kur plotësohen të gjitha kushtet e përshkruara në hadith.”*

Sheukani ka thënë: *“Shpërblimi i përmendur fitohet kur realizohen të gjitha kërkesat e përmendura në hadith: falja e namazit të sabahut me xhemat, qëndrimi ulur për të përmendur Allahun derisa të lindë dielli dhe falja e dy rekateve pas lindjes së diellit.”*

Bazuar në këtë që u përmend më lart, kushtet e përfitimit të shpërblimit të premtuar për qëndrimin ulur për të bërë dhikër pas namazit të sabahut deri në agim janë si vijon:

**Kushti i parë:** Falja e namazit të sabahut me xhemat, qoftë në xhami, në faltore apo në ndonjë vend tjetër, gjë që duket qartë

në hadith. Ndërsa kur nuk e fal namzin me xhemat, nuk e merr shpërblimin e premtuar.

**9. Kush falet në shtëpi si burri që ka arsye (për të mos u prezantuar në xhami) apo gruaja, apo si ata që jetojnë në vende ku xhamitë mbyllen pas namazit; gjithë këta a i fitojnë sevapet që janë përmendur në hadith?**

Po, shpresohet që ta fitojnë shpërblimin e përmendur në hadith. Të këtij mendimi janë një grup dijetarësh.

**Kushti i dytë:** Qëndrimi ulur derisa të lindë dielli.

**10. Kush del para kohe, a e merr shpërblimin?**

Ka dy raste:

a) Del pa arsye dhe nuk kthehet. Këtij i humbet shpërblimi.

b) Del me arsye dhe nuk vonohet shumë (vonohet aq kohë sa mund të merret abdes apo diçka e përafërt me këtë) pastaj kthehet në xhami, këtij nuk i humbet shpërblimi. Argument për këtë është hadithi që flet në përgjithësi: *“Kur njeriu sëmuret apo udhëton, i shkruhet çfarë ka punuar kur ishte i shëndetshëm dhe rezident (në vendin e vet).”*<sup>59</sup> Transmetohet se Ibën Umeri qëndronte për të bërë dhikër pas namazit të sabahut në xhaminë e Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) derisa hynte koha e duhasë (paradites) dhe nuk falej. Pastaj shkante në treg për të plotësuar nevojat e tij. Pastaj, duke u kthyer në familjen e tij, fillimisht falte dy rekate në xhami dhe më pas hynte në shtëpi.<sup>60</sup>

**11. A është kusht që namazi i sabahut të falet në kohën e tij të parë?**

Në tekstet e lartpërmendura duket qartë se kjo nuk është kusht.

---

59) Buhariu nr. 2996.

60) “Et-Tabekatu el-Kubra” nr. 109/4.

Kur njeriu e fal namazin e sabahut brenda kohës së vet dhe pret derisa përfundon koha gjatë së cilës nuk lejohet namazi pas lindjes së diellit, ky i përgjigjet kërkesave të hadithit, edhe sikur të ketë mbetur pak kohë nga lindja e diellit, pasi ta ketë falur namazin e sabahut.

**12. Personi që nuk e mban dot abdesin - si ai që nxjerr gjithmonë gazra, apo vuan nga urinimi i pavullnetshëm apo gruaja që vuan nga hemorragjia, këtyre a u mjafton abdesi i namazit të sabahut apo duhet të marrin abdes sërish?**

Kjo ngrihet mbi çështjen: personi që nuk e mban dot abdesin, a i prishet abdesi kur del koha e namazit? Sigurisht, që për këtë duhet të marrë abdes kur hyn koha e çdo namazi. Apo mjafton një abdes i vetëm, nëse ai nuk i prishet nga problemi i vazhdueshëm që ka?

Për këtë çështje ka një mosmarrëveshje të njohur në rrethet akademike. Sqarimi vjen si vijon:

**Mendimi i parë:** Është detyrë marrja e abdesit për çdo namaz. Kur hyn koha merr abdes dhe e fal namazin farz e nafile, edhe nëse i prishet abdesi për shkak të problemit të vazhdueshëm që ka, kjo nuk e dëmton aspak. Pastaj kur hyn koha e namazit tjetër, merr abdes. Ky është mendimi i medh’hebit (shkollës juridike) hanefi dhe hanbeli.

**Mendimi i dytë:** Nuk prishet abdesi. Ky është mendimi i medh’hebit maliki. Gjithashtu të njëjtin mendim ka Rabiun, Ikrima, Ejubi dhe në të anon Ibën Mundhiri.

**Mendimi i tretë** i referohet disa malikive.

Ata sqarojnë si vijon:

a. Nëse abdesi prishet në mënyrë të vazhdueshme, nuk është e domosdoshme dhe as e pëlqyeshme që të merret abdes, sepse këtij të sëmuri nuk i vlen abdesi, nuk e ndryshon gjendjen e tij duke qenë se ai përsëri e prish abdesin, nuk e mban dot atë.

b. Nëse e prish abdesin shpesh, atëhere pëlqehet marrja e tij sërish dhe nuk është detyrë.

**Më i saktë është mendimi i parë**, i cili duhet të merret në konsideratë, sidomos në kohën kur xhamitë kanë hapësirë dhe nuk janë të mbipopulluara. Ndërsa në kohën e kallaballëkut të madh, siç ndodh në kohën e haxhit dhe në Ramazan në Qaben e Shenjtë, njeriu e ka të vështirë të marrë abdes për çdo namaz. Në këtë rast, nuk është detyrë të merret abdes për çdo namaz përderisa nuk e prish atë nga ndonjë faktor tjetër. Sa i përket rastit kur Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i tha gruas me hemorragji: *“Merr abdes për çdo namaz”*, këtë hadith e kanë cilësuar të dobët një pjesë e ekspertëve të hadithit.<sup>61</sup>

**Kushti i tretë:** Qëndrimi në vendin ku ka falur namazin e sabahut.

### **13. Nëse çohet prej vendit ku ka falur namazin e sabahut, si në rastin kur kalon nga një vend në tjetrin brenda xhamisë, a e merr shpërblimin apo jo?**

Për këtë çështje dijetarët (Allahu i mëshiroftë) ndajnë mendime të ndryshme:

**Mendimi i parë:** Nuk duhet të lëvizë nga vendi ku ka falur namazin, sepse hadithi e thotë qartë: *“Pastaj qëndron ulur për të përmendur Allahun.”*

Ky mendim kundërshtohet nga dijetarë të tjerë që thonë se hadithi bën fjalë për rastet e përgjithshme dhe nuk mund t’i atribuohet çdo rasti.

**Mendimi i dytë:** Nuk është kusht qëndrimi ulur në të njëjtin vend ku ka falur namazin e sabahut, por mund të qëndrojë në çdo vend të xhamisë.

I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Robi vazhdon të jetë në namaz përderisa ai qëndron në vendin ku është falur.”* Pikërisht për këtë fjalë Junus bnu Ubejdi

---

61) Si p.sh.: Ebu Daudi, Nesaiu, Daru Kutni, Ibën Katani, Ibën Abdulberri, Ibën Rexhepi, Sheukani, Muslimi, Neuiu etj.

e ka pyetur Hasanin (Allahu qoftë i kënaqur me të): “A bëhet fjalë për vendin ku ka falur namazin?” Ai u përgjigj: “Jo, për gjithë xhaminë.”<sup>62</sup> Këtë mendim kanë zgjedhur një pjesë e dijetarëve, ekspertë të hadithit dhe juristë islam.

#### **14. A e ndërpret shpërblimin, e përmendur në hadith, për dhikrin pas namazit të sabahut tauafi?**

Për këtë çështje dijetarët (Allahu i mëshiroftë) kanë rënë në mosmarrëveshje:

Gjykimi për kushtin e qëndrimit ulur në vendin ku falet namazi i sabahut është gjykimi bazë mbi të cilin ndërtohet çështja e tauafit që kryhet në agim dhe kjo çështje u sqarua më lart. Faktikisht, tauafi nuk e ndërpret shpërblimin e dhikrit pas sabahut, sepse siç u sqarua nuk është kusht qëndrimi në vendin e faljes. Tauafi bëhet brenda Xhamisë së Shenjtë dhe kryerja e kësaj veprë nuk çënon kërkesat e hadithit, përkundrazi i plotëson ato më së miri.

#### **15. Kush e fal namazin në oborrin e Qabes së Shenjtë (apo në oborrin e Xhamisë së Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) në Medine) dhe pastaj dëshiron të bëjë dhikër derisa të lindë dielli dhe më pas të falë namazin, hyrja në Qabe a ia ndërpret shpërblimin këtij personi?**

Kjo çështje ndërtohet mbi një tjetër: oborri i xhamisë a merr gjykimin e saj (si pjesë e xhamisë) apo jo? Kjo temë është e diskutueshme mes dijetarëve (Allahu i mëshiroftë).

Sa i përket kësaj çështjeje, kemi dy raste:

a. Nëse oborri është prej xhamisë dhe i rrethuar me murin e saj, ai konsiderohet pjesë e saj. Kështu që lëvizja brenda kufijve të oborrit është njësoj si lëvizja brenda xhamisë dhe, si rrjedhojë, shpërblimi nuk ndërpritet.

62) El-Busairi pohon se zinxhiri i transmetimit të hadithit është i saktë, “Itihafu el-khiratu” 1014.

b. Nëse oborri është jashtë xhamisë dhe i ndarë prej saj, edhe sikur të jetë i rrethuar me mur të jashtëm, nuk konsiderohet prej xhamisë. Mund të thuhet: Nëse bëhet i vështirë qëndrimi ulur në oborrin e xhamisë, që nuk është prej saj, dhe ka nevojë të hyjë në të (në xhami), shpresohet ta ketë fituar shpërblimin, sepse lëvizja e tij është diçka e nevojshme.

Sikurse mund të thuhet: Nëse lëviz nga oborri dhe hyn në xhami, kjo lëvizje nuk ia ndërpret shpërblimin e përmendjes së Allahut, për shkak se ky vend (oborri) është afër xhamisë. Allahu e di më së miri.

**Kushti i katërt:** Duhet ta përmendë Allahun.

### **16. A ndërpritet shpërblimi nëse merret me diçka tjetër, pa bërë dhikër?**

Ka disa raste:

a. Kur flet për gjëra të lejuara (*mubah*) gjatë gjithë kohës, kjo bie në kundërshtim me hadithin e lartpërmendur të transmetuar nga Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të): “*Qëndron ulur në vendin e tij dhe nuk flet për gjëra të padobishme të kësaj bote.*” Besimtari nuk duhet ta humbasë këtë mirësi duke u marrë me fjalë që nuk i bëjnë dobi. Ai duhet të përpiqet ta shfrytëzojë këtë rast. I privuar është ai që privohet nga kjo mirësi e madhe.

Nëse dikush thotë: Në hadithin e transmetuar nga Xhabiri përmendet se sahabët flisnin pas namazit të sabahut, ndërsa Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) buzëqeshte.

Këtij i thuhet: Një pjesë e përgjigjes u përmend më lart. Gjithashtu shtojmë se nuk është kusht që ajo çfarë përmendet në hadith bëhej përditë në mënyrë të vazhdueshme. Ata flisnin nganjëherë apo në disa ditë. Ndërkaq Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) nuk fliste, por thjesht buzëqeshte. Ndoshta këtë e bënte për t’ua bërë qejfin atyre apo për shkaqe të

tjera të mundshme. Më lart u sqarua gjendja e paraardhësve tanë të mirë.

b. Merret me fjalë të lejuara shumicën e kohës. Një rregull thotë: “*Shumica merr gjykimin e tërësisë*”. Edhe kjo bie ndesh me hadithin. Mirëpo, siç u përmend, mirësia e përmendur në hadith i referohet qëndrimit ulur pas namazit të sabahut, me qëllim përmendjen e Allahut.

c. Pjesën më të madhe të kohës e shfrytëzon duke bërë dhikër. Kjo është në harmoni të plotë me hadithin, sepse merr gjykimin e tërësisë.

d. Të jetë gjatë gjithë kohës në gjumë. Nëse shumicën e kohës është në gjumë, nuk plotësohet kushti i hadithit. Nëse dremit pak, kjo nuk merret në konsideratë, sepse, përgjithësisht në shariat nuk merret në konsideratë ajo çfarë është e pakët.

### **17. A e ndërpresin shpërblimin punët e xhamisë, si p.sh. pastrimi dhe mirëmbajtja e saj?**

Nëse i bën këto punë duke e përmendur Allahun në pjesën më të madhe të kohës, shpresohet që lëvizja e tij brenda xhamisë (në dashtë Allahu) të mos ketë ndikim. Ky është mendimi më i saktë, sikurse u përmend.

### **18. Cila është vepra më e mirë gjatë kësaj kohe: dhikri i përgjithshëm apo leximi i Kuranit?**

Ka disa gjendje:

1. Dhikri i posaçëm, që thuhet në këtë kohë, është më i mirë se dhikri në përgjithësi dhe leximi i Kuranit. Dhikri që bëhet pas namazit të sabahut dhe lutjet e sabahut janë më të mira sesa leximi i Kuranit, sepse ky dhikër është synet të bëhet në këtë kohë.

2. Pas përfundimit të dhikrit, që bëhet në këtë kohë, dijetarët (Allahu i mëshiroftë) ndajnë mendime të ndryshme:

**Mendimi i parë:** dhikri në përgjithësi është më i preferuar sesa

leximi i Kuranit, sepse gjatë kësaj kohe dhikri ka ndikim më të madh në shpirt.

Ibën Musejbi është pyetur: *“Cila punë është më e mirë në kohën pas sabahut: leximi i Kuranit apo dhikri?”* Ai u përgjigj: *“Përgjithësisht, leximi i Kuranit është vepër më e mirë, mirëpo paraardhësit tanë të devotshëm gjatë kësaj kohe bënin dhikër.”*<sup>63</sup>

Kur u pyet Euzai se cila nga këto dy vepra është më e mirë, ai u përgjigj: *“Asgjë nuk mund të krahasohet me leximin e Kuranit, mirëpo paraardhësit tanë të devotshëm e kishin pjesë të punës së tyre të përditshme përmendjen e Allahut para lindjes së diellit dhe pas perëndimit të tij.”* Taberiu ka thënë: *“Kjo që thotë Euzai është më afër së vërtetës.”*<sup>64</sup>

Ky mendim është për t’u shqyrtuar, sepse Kurani është dhikri më i mirë.

**Mendimi i dytë:** Leximi i Kuranit është më i mirë, sepse Kurani është dhikër, madje është dhikri më i mirë. Nëpërmjet leximit të Kuranit fitohet shpërblim i madh. Ka shumë argumente që flasin për vlerën e leximit të Kuranit.

Në librin “Es-Sijeru” transmetohet se Ibën Ebi Lejla pasi falte namazin e sabahut, hapte Kuranin dhe lexonte derisa lindte dielli.

**Mendimi i tretë:** Veprohen të dyja (dhikri dhe leximi i Kuranit). Këtë mendim ka zgjedhur Gazaliu, i cili ka thënë se më e mira është që të shfrytëzohet kjo kohë përmes dhikrit dhe leximit të Kuranit.

**Mendimi më i saktë:** Shihet ajo që është më e dobishme dhe më e mirë për zemrën, gjë e cila mund të realizohet nëpërmjet dhikrit të përgjithshëm ose leximit të Kuranit. Sigurisht, përmirësimi i zemrës është prej urtësive dhe qëllimeve të ligjërimit të ibadeteve.

Ibën Kajimi (Allahu e mëshiroftë) thotë: *“Ndoshta njeriu ka ndonjë nevojë urgjente, hall apo problem që duhet ta zgjidhë. Nëse bën dhikër gjatë kësaj kohe, nuk do të përqëndrohej; ndërsa duke u lutur, ai përkushtohet me*

---

63) “Sherhu muhteseri khalilin” nr. 12/2.

64) “Sherhu sahihi El-Buhari” nga Ibën Betali nr.95/10.

*gjithë zemër dhe kjo i sjell përlësi, përgjërëm dhe frikërespekt ndaj Allahut. Në këtë rast, lutja është më e mirë dhe më e dobishme, edhe pse leximi i Kuranit dhe dhikri janë punët më të mira dhe shpërblehen më shumë. Kjo temë e rëndësishme duhet kuptuar mirë. Duhet bërë dallimi ndërmjet vlerës që mbart vepra në vetvete dhe vlerës që ajo ka në një kontekst, rrethanë a situatë të caktuar. Çdo gjëje duhet t'i jepet haku që i takon.”*

### **19. A e ndërpresin shpërblimin: mësimdhënia, marrja e diturisë dhe leximi i librave gjatë kësaj kohe?**

Për këtë çështje dijetarët (Allahu i mëshiroftë) ndajnë mendime të ndryshme:

**Mendimi i parë:** Këto punë nuk e ndërpresin shpërblimin, sepse dituria është prej dhikrit. Allahu i Lartësuar thotë:

«فَاسْأَلُوا أَهْلَ الذِّكْرِ إِنْ كُنْتُمْ لَا تَعْلَمُونَ»

**“Pyetini dijetarët e Librit nëse nuk e dini (këtë).”** (En-Nahl: 43)

Këtë mendim kanë zgjedhur një pjesë e dijetarëve.

**Mendimi i dytë:** Ndërpritet shpërblimi, sepse këto punë nuk përmenden në hadith, e sidomos kur kalon me to pjesën më të madhe të kohës.

Ibën Uehbi ka thënë se Imam Maliku pas namazit të sabahut nuk jepte mësim dhe nuk fliste derisa lindte dielli.

Nëse thuhet që dhënia dhe marrja e diturisë në xhami gjatë kësaj kohe, me gjithë dobitë dhe urtësitë që ka, e ndërpret shpërblimin, pa dyshim ne mund të theksojmë se dituria, sidoqoftë kur jepet apo merret, është prej adhurimeve vullnetare më të mira.

ImamAhmedi (Allahu e mëshiroftë) ka thënë “*Dija nuk krahasohet me asgjë, nëse njeriu ka qëllim të mirë në dhënien apo marrjen e saj.*”

Dituria është vepra vullnetare më e mirë pas farzeve (obligimeve). Ka një rregull në sheriat që thotë: “*Vepra që u bën dobi dhe të tjerëve*

*është me e mirë se ajo që i bën dobi vetëm personit që e vepron”.*

Pa dyshim marrja dhe dhënia e dijes është e dobishme për të gjithë, ndërsa namazi, dhikri dhe agjërimi i bëjnë dobi vetëm personit që i kryen. Nga fjalët dhe veprat e sahabëve dhe tabiinëve (gjenerata pas sahabëve) ka shumë dëshmi. Është e rëndësishme që kërkuesi i dijes ta programojë kohën, që çdo pune t’i kushtojë kohën që i përshtatet. Ndërsa lënia e veprave vullnetare dhe përkushtimi absolut ndaj diturisë, kjo është çështje që duhet shqyrtuar mirë. Në rastin kur ekzistojnë një mori veprash që duhen kryer në të njëjtën kohë, i jepet përparësi asaj që është më e mirë dhe më e dobishme, jo vetëm për personin që i kryen ato, por edhe për të tjerët.

Duhet ta dimë se veprat e mira vullnetare janë ushqim shpirtëror në rrugën e diturisë, që të japin fuqi për të përballuar vështirësitë e përhapjes së dijes dhe të thirrjes në fenë e Allahut. Adhurimi është fryt i diturisë; nëpërmjet tij pastrohet e përmirësohet zemra; me të njeriu forcohet në rrugën e drejtë dhe nuk humbet e nuk devijon.

Imam Dhehebiu ka thënë: *“Nëse sheh ndonjë nxënës serioz në kërkimin e diturisë, por të dobët në adhurime e vepra të mira, dije se ky është një përtac i përbuzur; nuk është i sigurtë në qëllimin e tij.”*

Mirëpo, kur ka shumë punë që duhen kryer në të njëjtën kohë, përhapja e diturisë dhe mësimi i njerëzve është gjëja më e mirë që mund të bëhet. Në këtë mënyrë fiton edhe shpërblimin e dhikrit pas sabahut deri në lindjen e diellit, sikurse u përmend më lart.

**Kushti i pestë:** Të ulet në vendfaljen e tij derisa të lindë dielli, siç duket qartë në hadithet e lartpërmendura dhe dëshmohet nga fjalët e veprat e paraardhësve tanë të devotshëm.

Në këtë kontekst, transmetohet se Mudrik bnu Aufi ka thënë: *“Kur e vizitova Bilalin në Sham e pashë ulur pas namazit të sabahut. I thashë: “Pse qëndrove këtu, o babai i Allahit?” Ai tha: “Pres lindjen*

*e diellit.*”<sup>65</sup>

**Kushti i gjashtë:** Të falen dy rekate namaz në xhami pasi dielli të ngrihet në horizont dhe të ketë përfunduar koha gjatë së cilës namazi është i ndaluar.

## **20. A e ndërpret shpërblimin apo jo namazi jashtë xhamisë?**

Për këtë çështje dijetarët (Allahu i mëshiroftë) kanë rënë në mosmarrëveshje:

**Mendimi i parë:** E ndërpret shpërblimin, sepse namazi duhet të falet patjetër në xhami, sipas kontekstit të qartë të haditheve të lartpërmendura, duke qenë se e gjithë çështja ka të bëjë vetëm me xhaminë. Ky mendim shprehet qartë edhe në fjalët e juristëve islam. Mendohet se kjo është më e mira që mund të bëhet.

**Mendimi i dytë:** Nëse del nga xhamia dhe e fal namazin jashtë saj, shpërblimi nuk ndërpritet nga ky veprim.

**Mendimi më i saktë:** Është mendimi i parë, për arsyet e lartpërmendura. Ndërsa mendimi i dytë është larg së vërtetës. Teksti është i qartë. Nëse thuhet se ky namaz mund të falet jashtë xhamisë, nuk do të punohej me hadithin dhe nuk do të plotësoheshin kushtet e përmendura në të.

## **21. A është kusht të qenurit i pastër (me abdes) gjatë qëndrimit në vendin e faljes duke përmendur Allahun pas sabahut?**

Nuk është kusht. Në tekstin e hadithit përmendet dhikri në përgjithësi dhe dihet se abdesi nuk është kusht për të bërë dhikër.

Mund të thuhet: Si mund të falet namazi? Përgjigjja: Kush dëshiron të falë namazin, le të marrë abdes, sikurse u përmend.

---

65) “Musaneef bnu Ebi Shejbe” nr. 66383.

**22. Nëse thuhet se tauafi nuk e ndërpret shpërblimin, çfarë të bëjë në rast se e përfundon tauafin në kohën e namazit të ishrakut: a të falë më parë dy rekatet e tauafit apo dy rekatet e ishrakut (agimit)?**

**Mendimi më i saktë** është ai që pohon se u jepet përparësi dy rekateve të ishrakut, sepse kjo është koha e tij. Në këtë mënyrë punohet me tekstin e hadithit. Përsa i përket dy rekateve të tauafit, koha e tyre është e gjërë dhe mund të falen më vonë.

**23. A mund të futen te njëra-tjetra dy rekatet e ishrakut me dy rekatet e tauafit?**

Kjo është çështje e diskutueshme ndërmjet dijetarëve (Allahu i mëshiroftë):

**Mendimi i parë:** Nuk lejohet ndërputja, sepse ato janë synete të pavarura nga njëri-tjetri; secili është më vete. Këto synete janë të synuara në vetvete dhe nuk mund të futen te njëri-tjetri, njësoj sikur nuk mund të futen te njëra-tjetra dy rekatet e tauafit dhe synetet që falen para e pas namazeve farz. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam. Sepse, në origjinë, adhurimet nuk futen te njëra-tjetra. Sheriati i nxit njerëzit që të shtojnë adhurimet.

Transmetohet nga Madan bnu Talha El-Umejri se ai takoi shërbëtorin e Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), Theubanin dhe i kërkoi që t'i tregonte se çfarë punë duhet të bënte për t'u futur në Xhenet; t'i tregonte për veprën që Allahu e do më shumë. Theubani i tha që të njëjtën pyetje i kishte bërë Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe ai i ishte përgjigjur: *“Bëj sa më shumë sexhde për Allahun (falu sa më shumë), sepse për çdo sexhde që bën për Allahun, Allahu do të ngrejë një gradë dhe do të të falë një gjynah.”*<sup>66</sup>

---

66) Muslimi 225.

**Mendimi i dytë:** Lejohet të futen te njëri-tjetri synetet e tauafit dhe ato të ishrakut, njësoj sikur lejohet (sipas tyre) të futen te njëri-tjetri synetet e tauafit dhe synetet që falen para dhe pas namazeve. Ky është mendimi i një pjese të dijetarëve.

**24. Nëse nuk i ka falur dy rekatet para namazit të sabahut, me cilin namaz t’ia nisë: me synetet e ishrakut apo me synetet e sabahut? Duke marrë në konsideratë mendimin që synetet e sabahut mund të kompesohen pasi del koha gjatë së cilës namazi është i ndaluar.**

Në fakt, ky është mendimi i shumicës së dijetarëve.

**Mendimi më i saktë** është që fillimisht të falen synetet e ishrakut, meqë është koha e tij, e sidomos kur merret në konsideratë mendimi se ky namaz duhet falur menjëherë sapo përfundon koha gjatë së cilës namazi ndalohet. Ndërkaq koha e kompesimit të syneteve të sabahut është e gjërë, sikurse do të sqarohet më pas.

Një rregull thotë: *“I jepet përparësi asaj çfarë i druhen se ikën koha; i jepet përparësi syneteve që kryhen në atë kohë, ndaj të tjerave; i jepet përparësi veprave që kanë vlerë në atë kohë, ndaj të tjerave”*.

Edhe sipas mendimit se namazi i ishrakut (agimit) është namazi i duhasë (paradites) mund të thuhet se duhaja ka dy gjendje, apo dy kohë dhe secila prej tyre ka veçoritë e veta.

A mund të thuhet se në fillim falen synetet e sabahut duke marrë në konsideratë radhën ndërmjet syneteve (që synetet e sabahut janë para syneteve të ishrakut)?

**Mendimi më i saktë është:** Nëse synetet nuk i përkasin të njëjtit lloj, siç janë synetet e sabahut dhe ato të duhasë, ato nuk falen sipas radhës. Nëse synetet i përkasin të njëjtit lloj, siç janë synetet *reuatib* (synetet e forta para dhe pas namazeve farz), mundet që të falen sipas radhës. Allahu e di më së miri.

### **25. A mund të futen te njëra-tjetra synetet e sabahut dhe ato të duhasë?**

Kjo ndërfutje nuk mund të ndodhë, sepse secili prej tyre është synet i synuar në vetvete. Nuk mund të ketë ndërfutje te synetet që falen para e pas namazeve farz apo ndërmjet vitrit dhe syneteve pas namazit të jacisë. Sepse, në origjinë, nuk lejohet ndërfutja.

### **26. Cila vepër është më e mirë: zgjatja e namazit të natës apo dhikri pas namazit të sabahut deri në ishrak (agim)?**

Për ta sqaruar më mirë: disa njerëz (veçanërisht në dhjetë netët e fundit të ramazanit) pyesin: A është më mirë ta shfrytëzojmë kohën duke bërë ibadet deri në lindjen e agimit apo të qetësohemi ca, që pastaj të bëjmë dhikër pas namazit të sabahut deri në faljen e namazit të ishrakut (agimit)?

Ka disa gjendje:

**E para:** Bashkimi ndërmjet tyre është më i mirë.

**E dyta:** Ibadeti gjatë gjithë natës në dhjetë netët e fundit të Ramazanit është më i mirë sesa dhikri pas sabahut deri në agim dhe më pas falja e namazit të ishrakut (agimit), sepse në njërin nga këto dhjetë netë është Nata e Kadrit, e cila është më e mirë se 1000 muaj dhe kushdo që bën ibadet gjatë Natës së Kadrit i falen gjynahet.

**E treta:** Në ditët e tjera të vitit kur duhet bërë përzgjedhje midis ibadeteve të shumta – përveç dhjetë netëve të fundit të Ramazanit – në këtë rast përqëndrohemi tek vlera e ibadeteve, shohim vlerën e kohës dhe të ibadetit:

1. Koha e suhurit (syfyrit) fillon nga një e treta e fundit e natës deri në agim. Është koha kur Allahu zbret, ashtu siç i shkon madhësisë së Tij; është koha në të cilën pranohet lutja; është koha e kërkimit të faljes; është pjesa më e mirë e kohës kur falet

namazi i natës. Për këto arsye, koha e suhurit (syfyrit – para agimit) është më e mirë se ajo pas namazit të sabahut.

2. Qëndrimi ulur me qëllim përkujtimin e Allahut deri në agim është synet (vepër e pëlqyer), ndërkaq shpërblimi varet nga pritja dhe namazi në fund të kohës.

3. Përparësia sipas vlerës së punës: Duke medituar rreth teksteve të transmetuara për vlerën e namazit të natës, mund të pohojmë se namazi i natës është më i mirë për arsye të larmisë së vlerave të veprave që kryehen gjatë tij. Sa më të larmishme të jenë veprat dhe vlerat e këtyre punëve, aq më të mira janë ato në raport me të tjerat. Mirëpo një pjesë e dijetarëve mendon se është më mirë të flihet para namazit të sabahut, me qëllim që ky gjumë ta ndihmojë njeriun për të bërë dhikër pas namazit. Kjo çështje ka nevojë për më shumë meditim. Njeriu duhet të shohë se çfarë është më e mirë dhe më e dobishme për zemrën e tij.

**27. Si është më e mira në ditën e xhuma: të bëjë dhikër pas sabahut derisa të lindë dielli apo të shkojë në shtëpi që të përgatitet për xhuma, të lahët dhe të vijë në xhami herët për të falur namazin e xhumasë?**

Ka dy gjendje:

a) Sa i përket imamit, nuk ka ndonjë problem, sepse nuk është synet që imami të vijë herët në xhami. Ai mund të prezantohet në kohën e hutbes. Kështu ka vepruar Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Kur imami hipën në mimber, mbyllën regjistrat.”*<sup>67</sup>

Nga Tradita Profetike duket qartë se Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) bënte dhikër deri në agim çdo ditë, edhe në ditën e xhuma. Kështu është përshtuar gjendja e tij në hadithe. Prandaj jepet ky gjykim i përgjithshëm përderisa nuk ka

67) Buhariu nr. 881.

argument që të pohojë të kundërtën.

b) Kur bëhet fjalë për besimtarët e tjerë, përveç imamit, kjo çështje bazohet tek një tjetër: kur është koha e parë e ditës së xhuma? Për fillimin e kohës së saj ka disa mendime:

**Mendimi i parë:** Fillon pas lindjes së agimit. Ky është mendimi i medh'hebit (shkollës juridike) të Imam Shafiut dhe Imam Ahmedit.

**Mendimi i dytë:** Fillon pas lindjes së diellit. Është mendimi i medh'hebit hanefi dhe këtë opinion ka zgjedhur Ibën Haxheri.

**Mendimi i tretë:** Fillon pasi dielli arrin në zenitin. Ky është mendimi i medh'hebit të Imam Malikut.

**Më i saktë është mendimi** i dytë që pohon se koha fillon pas lindjes së diellit, të cilin e pranojnë një pjesë e madhe e dijetarëve. Paraardhësit tanë të devotshëm kujdeseshin që të prezantoheshin herët, në fillim të ditës, për të falur namazin e xhumasë. Nënvlërësimi i syneteve është një humbje e madhe nga shpërblimi i këtyre ibadeteve. Shumë njerëz prezantohen në xhami me vonesë, pak kohë para se të fillojë hutbja dhe ndoshta afër kohës së faljes së namazit apo kur është duke u falur namazi i xhumasë. Vetëm prej Allahut kërkohet ndihmë! Atyre u humbasin mirësi të mëdha si p.sh.: namazi nafile (vullnetar), leximi i Kuranit, dhikri etj. Gjithashtu u humbet shpërblimi i madh i ditës së xhuma, e cila është dita më e mirë.

O Zot, mos na privo nga mirësitë e Tua.

Në “*Sahihun e Buhariut*” dhe “*Sahihun e Muslimit*” transmetohet nga Ebu Hurejra se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Kush merr gusul (e lan gjithë trupin) në ditën e xhuma, njësoj si gusuli i xhunubllëkut, pastaj shkon herët në xhami, ky shpërblehet sikur bën kurban për Allahun një deve. Kush shkon në orën e dytë, shpërblehet si të bëjë kurban një lopë; në orën e tretë, një dele; në orën e katërt, një pulë; kush shkon në xhami në orën e pestë, afrohet tek Allahu sikur ka*

*dhënë sadaka një vezë. Kur del imami, engjejt prezantohen për të dëgjuar hutben.*"<sup>68</sup>

Dikush mund të pyesë: A është mirë të bëhet dhikër deri në agim, pastaj të pushohet dhe pastaj të shkohet në xhami? Apo të mos bëhet dhikër pas sabahut deri në agim, por të pushohet në këtë kohë dhe pastaj të shkohet në xhami?

Sa i përket përgjigjes së kësaj pyetje, mund të thuhet se ai që do të shkojë për namazin e xhumasë pas lindjes së diellit, duke u prezantuar në xhami në orën e parë të agimit, është më mirë për të që të mos qëndrojë pas namazit të sabahut për të bërë dhikër deri në lindjen e diellit. Ndërsa ai që nuk synon të dalë herët në xhami, në kohën e parë pas lindjes së diellit, është më mirë të bëjë dhikër deri në lindjen e diellit, pastaj të shkojë që të përgatitet për xhuma dhe të shkojë në xhami në orën e dytë ose të tretë ose më pas.

Nga transmetimet që kanë ardhur për sahabët dhe paraardhësit tanë të mirë pas tyre, duket qartë se ata kanë bërë dhikër pas sabahut deri në lindjen e diellit çdo ditë të javës, edhe në ditën e xhuma.

Mund të thuhet se njeriu le të shohë atë çfarë është më e mirë për përmirësimin e zemrës së tij, në pamundësi për t'i bërë gjithë ato punë, sepse përmirësimi i zemrës dhe pastrimi i shpirtit është prej urtësisë së ligjërimit të adhurimeve.

## **28. Cila punë është më e mirë: të bëjë dhikër deri në lindjen e diellit, të fitojë shpërblimin e këtij ibadeti, apo të marrë pjesë në xhenaze?**

Ka dy raste:

a) Nëse pjesmarrja në xhenaze dhe falja e namazit të xhenazesë është *farz ajn* (obligim individual) duke qenë se nuk ka person tjetër që ta bëjë këtë punë, sigurisht që në këtë rast i jepet përparësi obligimit para synetit.

<sup>68</sup>) Buhariu nr. 881; Muslimi nr. 850.

b) Nëse gjendet dikush që merr pjesë në xhenaze, e fal namazin e xhenazes dhe e varros të vdekurin, kjo vepër hyn në kategorinë e farzeve kifaje (obligimeve kolektive), ndërsa dhikri pas sabahut derisa lind dielli është synet. Në këtë kontekst, shpërblimi i përmendur në hadith *“sikur të ketë kryer haxhin dhe umrën”* është më i madh se shpërblimi *“një apo dy kiratë”*, duke ditur që kirati është shpërblimi sa mali i Uhudit apo më i madh se ai.

I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Kush e ndjek xhenazen, shpërblehet me një kirat.”*<sup>69</sup>

Gjthashtu ka thënë: *“Secila prej të dyjave (d.m.th. dy kirateve) është më e madhe sesa Uhudi.”*<sup>70</sup> Allahu e di më së miri.

**Plotësim:** Mundet që ndjekja e xhenazesë dhe pjesmarrja në të të jetë më e mirë se dhikri pas sabahut derisa lind dielli, duke marrë në konsideratë parimin e sigurimit të dobisë dhe largimit të dëmit. Kjo konsiderohet vepër më e mirë, duke e parë në aspekte të tjera, si në rastin e pjesmarrjes në xhenazenë e prindërve, të bashkëshortes, të vëllezërve, të fëmijëve apo të afërmeve të tjerë, ngaqë kjo ka të bëjë me ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve të gjakut.

### **29. A mund të kompesohet namazi i ishrakut (agimit), duke marrë në konsideratë mendimin që ai është synet më vete?**

Kjo është çështje e diskutueshme ndërmjet dijetarëve (Allahu i mëshiroftë):

**Mendimi i parë:** Kompesohet. Bazuar në këtë mendim namazi i ishrakut ka dy rekate. Hyn në namaz me nijetin e synetit të ishrakut (agimit). Ai që nuk ka mundur ta falë këtë namaz, mund ta kompesojë. Ky namaz ka kohën e vet, por nëse ka pasur arsye që nuk e ka falur në kohën e vet, vepron sipas hadithit të Profetit

---

69) Buhariu nr. 1323.

70) Nesaiu nr. 1997.

(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) *“Kush e harron namazin apo e ka zënë gjumi, e kompeson atë në momentin që kujtohet apo zgjohet nga gjumi.”*

(Transmeton Muslimi)

**Mendimi i dytë:** Nuk kompesohet, sepse ky namaz nuk mund të zëvendësohet pasi kalon koha e agimit. Është prej syneteve me kohë të përcaktuar. Në origjinë, nuk lejohet kompesimi derisa të vijë argumenti që pohon të kundërtën.

**Më afër së vërtetës:** Është mendimi që nuk e lejon kompesimin e këtij namazi, nëse nuk plotësohen kushtet e lartpërmendura.

### **30. A mund të kompesohet namazi i duhasë (paradites), duke marrë në kosideratë mendimin e atyre që pohojnë se namazi i ishrakut (agimit) është namazi i duhasë?**

Sa i përket kësaj çështjeje dijetarët (Allahu i mëshiroftë) ndajnë mendime të ndryshme:

**Mendimi i parë:** Kompesohet edhe pas kohës së zenitit. Ky veprim do të ishte i saktë, edhe nëse kompesohet pas namazit së drekës. Të këtij mendimi janë një pjesë e juristëve islam.

**Mendimi i dytë:** Nuk kompesohet. Ky është mendimi i shumicës së juristëve islam.

**Më afër së vërtetës:** Është mendimi që pohon se synetet kompesohen. Në këtë kontekst flet hadithi: *“Kush e harron namazin apo e ka zënë gjumi, e kompeson atë në momentin që kujtohet apo zgjohet nga gjumi.”*<sup>71</sup> Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) flet për *“namazin”* në përgjithësi dhe kjo përfshin namazin farz dhe namazin nafile, namazin që falet në kohë të caktuar dhe namazin që nuk ka kohë të caktuar. Është transmetuar se Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi

---

71) Muslimi nr. 315.

të) i ka kompesuar synetet e sabahut dhe synetet e drekës.<sup>72</sup>

A kompensohen këto synete në mënyrë absolute (pa kufizime dhe pa kushte)?

**Mendimi më i saktë** është se duhen evidentuar dy raste:

I pari: Nëse e lë namazin për ndonjë arsye, më e mira është që ta kompensojë, duke vepruar në përputhje me hadithin e lartpërmendur.

I dyti: Nëse e lë pa ndonjë arsye, a mund të bëhet analogji me rastin e kompesimit të farzit të lënë pa arsye? Kjo çështje përmban mundësi të ndryshme, sepse edhe tekstet që i mbështesin ato janë të tilla. Allahu e di më së miri.

**31. Si mund të bëjmë bashkimin ndërmjet mendimit se namazi i ishrakut (agimit) është namazi i duhasë (paradites) dhe fjalës së Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): “Namazi i të penduarve është atëhere kur të vegjëlit e devesë ta ndjejnë nxehtësinë e diellit.”; si është më mirë? Të falet namazi në fillim të ditës apo kur dielli të bëhet i nxehtë?**

Ibën El-Xheuzi thotë: *“Koha më e mirë për faljen e tij është atëhere kur dielli ngrihet në horizont.”*

Mënyra e bashkimit ndërmjet hadithit që flet për shpërblimin e namazit të ishrakut (që falet pas lindjes së diellit) dhe hadithit të lartpërmendur është si vijon:

- Mund të thuhet se në të dy hadithet nuk ka diçka që të tregojë se veprimi sipas njërit hadith është më i mirë sesa veprimi sipas tjetrit.

- Mund të bëjmë bashkimin ndërmjet të dyja gjërave dhe të punohet me të dyja hadithet, sidomos duke pasur parasysh se koha e duhasë zgjat deri para zenitit - para se të thirret ezani për namazin e drekës. Kur e fal në fillim të kohës, nuk do të thotë që

---

72) Transmeton Buhariu. Në librin “Musanef” 19/2 Ibën Ebi Shejbe transmeton se Abdurrahman bnu Ebi Lejla ka thënë se të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) kur i humbisnin katër rekate para namazit të drekës, i falte ato pas dreke.

të mos e falë gjithashtu edhe në fund të saj, sepse namazi ka më shumë se dy rekate. Është njësoj si personi që e ndan namazin e tij të natës në dy kohë: në fillim të natës dhe në fund të saj.

- Çdo hadith përmban një formë të caktuar. Kush qëndron pas namazit të sabahut për të bërë dhikër deri pas lindjes së diellit, më mirë për këtë është që ta falë namazin e duhasë në fillim të kohës. Kush nuk qëndron pas sabahut për të bërë dhikër, më mirë për këtë është që ta vonojë namazin e duhasë deri në kohën kur dielli nxehet më shumë. Ky lloj harmonizimi ndërmjet haditheve është i njohur tek njerëzit e dijes.

- Mund të zgjidhet edhe me mënyrën preferenciale përmes zbatimit të rregullave që bëjnë dallimin ndërmjet veprave të mira sipas vlerës së tyre. Disa prej këtyre rregullave po i përmendim në vijim:

a. Një rregull thotë: *“Shpërblimi varion në varësi të gradës së mirësisë dhe vlerës së veprës. Nëse janë dy vepra identike në çdo aspekt, shpërblimi më i madh është për veprën që bëhet më shumë.”*

El-Kerafiu ka thënë: *“Përgjithësisht, dobiet dhe interesat më të mëdha janë tek ato adhurime që bëhen më shumë.”*;

*“Vepra që bëhet më shumë është më e mirë dhe më e vlefshme.”*

Pa dyshim që qëndrimi ulur për të bërë dhikër pas namazit të sabahut dhe namazit të ishrakut përmbajnë më shumë ibadete se namazi i duhasë i veçuar në mesditë.

b. Ky rast bën pjesë në rregullin: *“Më parësore është vepra vlera e së cilës ka të bëjë me vetë ibadetin, sesa vepra që i referohet kohës dhe vendit.”*

c. Gjithashtu ky rast shpjegohet edhe me rregullin: *“Vepra më e mirë është ajo që ndikon më shumë në përmirësimin e zemrës. Gradat dhe vlerat e veprave nuk përcaktohen nga forma dhe sasia e tyre, por ato dallojnë nga fakti sesa ndikojnë në zemër.”*

Një rregull tjetër: *“Adhurimi që bëhet nëpërmjet zemrës është më i madh se adhurimi që bëhet përmes shqisave dhe gjymtyrëve.”*

*“Vlera ndryshon në varësi të personave.”*

**Mbyllja**

**Zoti ynë, të lutemi rregulloji zemrat tona dhe pastroji e lartësoji shpirtrat tanë; përgatitna për sjellje të drejtë që të ndihmojnë fenë Tënde, Librin Tënd, Traditën e të Dërguarit Tënd, robërit e Tu besimtarë dhe robërit e Tu të shtypur e të brengosur!**

**E lus Allahun që, me mirësinë dhe bujarinë e Tij, ta lehtësojë një takim tjetër në rrugën e dijes dhe të drejtësisë.**

## **Përmbajtja**

<i>Parathënie</i> .....	3
<i>Faktorët e qëndrueshmërisë</i> .....	5
<i>Frytet e adhurimit</i> .....	7
<i>Adhurimi i humbur</i> .....	9
<i>Agimi</i> .....	13
<b><i>Kapitulli i parë</i></b> .....	17
<i>Parathënie për dhikrin pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit</i> .....	17
<i>I. Përkufizimi i ishrakut (agimit) dhe koha e tij</i> .....	18
<i>II. Shembuj për kujdesin që tregonin paraardhësit tanë të mirë (Allahu i mëshiroftë) ndaj dhikrit pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit</i> .....	18
<i>III. Shkaqet pse njerëzit e kanë braktisur synetin e përmendjes së Allahut pas faljes së namazit të sabahut deri në lindjen e diellit</i> .....	20
<i>IV. Gjurmët që lë në besimin e njeriut dhikri pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit</i> .....	28
<i>V. Gjykimi për gjumin pas namazit të sabahut; është subjekt i mosmarrëveshjeve mes dijetarëve (Allahu i mëshiroftë)</i> .....	34

### **Kapitulli i dytë**

<i>Dispozitat e dhikrit të ishrakut (agimit); në këtë kapitull trajtohen 9</i>	<i>9</i>
<i>çështje .....</i>	<i>38</i>
<i>1. Emërtimi “namazi i ishrakut”, pse? .....</i>	<i>38</i>
<i>2. Gjykimi për dhikrin pas namazit të sabahut deri në lindjen e</i>	
<i>diellit .....</i>	<i>38</i>
<i>3. Vlera e qëndrimit ulur në vendin e faljes pas namazit të sabahut</i>	
<i>me qëllim përmendjen e Allahut.....</i>	<i>40</i>
<i>4. Fillimi dhe fundi i kohës së qëndrimit në vendin e faljes për të</i>	
<i>përmendur Allahun .....</i>	<i>41</i>
<i>5. Nëse njeriu e ndërpret dhikrin dhe largohet nga xhamia para</i>	
<i>lindjes së diellit, a shpërblehet për kohën e qëndrimit në xhami? ....</i>	<i>42</i>
<i>6. Gruas në xhami, të sëmurit në spital, rojeve dhe atyre që kanë</i>	
<i>detyra në vende të caktuara, gjithë këtyre a u lejohet që të bëjnë</i>	
<i>dhikër në vendin ku falin namazin, apo është kusht që kjo të ndodhë</i>	
<i>në xhami? .....</i>	<i>42</i>
<i>7. A është kusht dhikri kur qëndron ulur, në vendin e faljes, pas</i>	
<i>namazit të sabahut për të fituar shpërblimin e përmendur në hadith</i>	
<i>dhe për zbatimin e këtij syneti? .....</i>	<i>43</i>
<i>8. Gjykimi për fjalët dhe bisedat gjatë kësaj kohe .....</i>	<i>44</i>
<i>9. Qëndrimi në vendin e faljes për të marrë dije përmes mësimëve</i>	
<i>apo përmes studimit individual pas sabahut deri në lindjen e</i>	
<i>diellit, a e ndërpret shpërblimin e përmendur në hadith? .....</i>	<i>46</i>

### **Kapitulli i tretë**

<i>Dispozitat për namazin e ishrakut (agimit, që falet pas lindjes së</i>	
<i>diellit); ky kapitull trajton 31 çështje.....</i>	<i>49</i>

1. Namazi i ishrakut (namazi i agimit, që falet pas lindjes së diellit) .....	50
2. Dy rekatet e namazit të ishrakut, a janë ato të namazit të duhasë (paradites) apo është namaz më vete? .....	50
3. Përmbledhje e vlerave e mirësive të dhikrit pas namazit të sabahut dhe të namazi të ishrakut (agimit), e përfituar nga hadithet që flasin për këtë çështje .....	56
4. Numri i rekateve të namazit të ishrakut (agimit) .....	57
5. Koha e tij.....	57
6. A ka kohë të limituar namazi i ishrakut? E thënë ndryshe: A duhet të falet menjëherë sa hyn koha e tij apo ka hapësirë kohore?.....	58
7. A mund të futen te njëra-tjetra dy rekatet e ishrakut dhe dy rekatet e duhasë? .....	59
8. Kushtet për fitimin e shpërblimit të caktuar për dhikrin pas namazit të sabahut deri në lindjen e diellit.....	59
9. Kush falet në shtëpi si: burri që ka arsye (për të mos u prezantuar në xhami) apo gruaja, apo ata që jetojnë në vende ku xhamitë mbyllen pas namazit; a i fitojnë sevapet që janë përmendur në hadith? .....	60
10. Kush del para kohe, a e merr shpërblimin?.....	60
11. A është kusht që namazi i sabahut të falet në kohën e tij të parë? .....	60
12. Personi që nuk e mban dot abdesin - si ai që nxjerr gjithmonë gazra apo vuan nga urinimi i pavullnetshëm apo gruaja që vuan nga hemorragjia -, këtyre a u mjafton abdesi i namazit të sabahut apo duhet të marrin abdes sërish?.....	61
13. Nëse çohet prej vendit ku ka falur namazin e sabahut, si në	

*rastin kur kalon nga një vend në tjetrin brenda xhamisë, a e merr shpërblimin? ..... 62*

*14. A e ndërpret kryerja e tauafit shpërblimin e përmendur në hadith për dhikrin pas namazit të sabahut?..... 63*

*15. Kush e fal namazin në oborrin e Qabes së Shenjtë (apo në oborrin e Xhamisë së Profetit - paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të - në Medine) dhe pastaj dëshiron të bëjë dhikër derisa të lindë dielli dhe më pas të falë namazin, hyrja në Qabe a ia ndërpret shpërblimin këtij personi?..... 63*

*16. A ndërpritet shpërblimi nëse merret me diçka tjetër, pa bërë dhikër? ..... 64*

*17. A e ndërpresin shpërblimin punët e xhamisë si p.sh. pastrimi dhe mirëmbajtja e saj?..... 65*

*18. Cila është vepra më e mirë gjatë kësaj kohe: dhikri i përgjithshëm apo leximi i Kuranit? ..... 65*

*19. A e ndërpresin shpërblimin: mësimdhënia, marrja e diturisë dhe leximi i librave gjatë kësaj kohe?..... 67*

*20. A e ndërpret shpërblimin falja e këtij namazi jashtë xhamisë?... 69*

*21. A është kusht të qenurit i pastër (me abdes) gjatë qëndrimit në vendin e faljes duke përmendur Allahun pas sabahut?..... 69*

*22. Në rast se e përfundon tauafin në kohën e namazit të ishrakut, nëse thuhet se tauafi nuk e ndërpret shpërblimin, çfarë të bëjë? A të falë më parë dy rekatet e tauafit apo dy rekatet e ishrakut (agimit)? 70*

*23. A mund të futen te njëra-tjetra dy rekatet e ishrakut me dy rekatet e tauafit?..... 70*

*24. Nëse nuk i ka falur dy rekatet para namazit të sabahut, me cilin namaz t'ia nisë: me synetet e ishrakut apo me synetet e sabahut? Duke marrë në konsideratë mendimin që synetet e sabahut mund kompesohen pasi del koha gjatë së cilës namazi është i ndaluar ..... 71*

*25. A mund të futen te njëra-tjetra synetet e sabahut dhe ato të duhasë? ..... 72*

26. Cila vepër është më e mirë: zgjatja e namazit të natës apo dhikri pas namazit të sabahut deri në ishrak (agim)?.....	72
27. Si është më e mira në ditën e xhuma: të bëjë dhikër pas sabahut derisa të lindë dielli apo tëshkojë në shtëpi që të përgatitet për xhuma, të lahet dhe të vijëherët në xhami për të falur namazin e xhumasë?.....	73
28. Cila punë është më e mirë: të bëjë dhikër deri në lindjen e diellit që të fitojë shpërblimin e këtij ibadeti apo të marrë pjesë në xhenaze? .....	75
29. A mund të kompesohet namazi i ishrakut (agimit), duke marrë në konsideratë mendimin që ai është synet më vete? .....	76
30. A mund të kompesohet namazi i duhasë (paradites), duke marrë në konsideratë mendimin e atyre që pohojnë se namazi i ishrakut (agimit) është namazi i duhasë? .....	77
31. Si mund të bëjmë bashkimin ndërmjet mendimit se namazi i ishrakut (agimit) është namazi i duhasë (paradites) dhe fjalës së Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): “Namazi i të penduarve është atëhere kur të vegjëlit e devesë ta ndejnë nxehtësinë e diellit.” Si është më mirë? Të falet namazi në fillim të ditës apo kur dielli te behet i nxehte?.....	78
Mbyllja.....	80